

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5650
E martë, 11 dhjetor 2018
çmimi 0.40 €

Adem Demaçi ishte edhe simbol i rezistencës politike

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

ADEM DEMAÇI DHE DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT E KOMBEVE TË BASHKUARA F. 11

Behxhet Sh. SHALA, drejtor ekzekutiv i KMDLNj-së



MINISTRI ISMAILI: NDALËM KORRUPSIONIN NË BLERJEN E BARNAVE F. 7

GRABOVCI: KAM PRITUR TË JEM NË LISTAT E SHËRBIMIT SERB PËR LIKUIDIM, POR KURRË NË LISTAT E SHOQIPTARËVE F. 6

EKONOMI

THAÇI DHE MINXHOZI DISKUTOJNË PËR BASHKËPUNIMIN NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE F. 9

RRITET KOSTOJA E NDËRTIMIT F. 8

KULTURË

NJË LIBËR DHE NJË AUTORE E JASHTËZAKONSHME F. 13



Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

SPORT

MAGANI: KOSOVA ENDE ËSHTË PAS SHOIPËRISË F. 16

FLET PËR "EPOKËN E RE", ZENUN PAJAZITI | FAQE 4-5

Përfshirjen e presidentit në dialog duhet ta shohim si avantazh për vendin

- PDK-ja është përplatformë gjithëpërfshirëse në dialog

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, ka bërë me dije se ky subjekt politik e përkrah një platformë nga e cila del një ekip i përbashkët për dialogun me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se e mirëpret gatishmërinë e PSD-së për dialogun,

por ka theksuar se çdo tendencë për ta penguar rolin kushtetues të secilit, qoftë edhe të presidentit të vendit, do të dështojë. Pajaziti ka thënë se përfshirja e presidentit me përgjegjësit e tij kushtetuese që ka duhet parë si avantazh për Kosovën, e jo të luftohet. Sipas tij, presidenti Thaçi është një prej

protagonistëve kryesor në të gjitha proceset që ka kaluar Kosova. "Nëse dikush kalkulon me përjashtime ose me tendencën që nëpërmjet këtij procesi ta përjashtojë dikë, PDK-ja nuk është pro kësaj. PDK-ja është për përfshirjen e të gjithëve në vendimmarrje", ka thënë Pajaziti

Ambasadorët e Quintit: Të ndëshkohen zyrtarët e korrumpuar

Në hapje të "Javës Kundër Korrupsionit 2018" ambasadorët e vendeve perëndimore në Kosovës u kanë bërë thirrje institucioneve vendore të tregojnë vendosmëri në luftimin e korrupsionit. Në një tryezë të organizuar nga shoqëria civile ata kanë deklaruar se ligjet e miratuar për këtë fushë duhet të zbatohen, të ndëshkohen zyrtarët e korrumpuar dhe të mos ketë ndikim të politikës në gjyqësor | FAQE 3



Mbi 600 zyrtarë të lartë publikë mbajnë më shumë se një pozitë | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Mogherini kërkon heqjen e taksës, reagon qeveria

Shefja e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini, i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës ta revokojë taksën prej 100 përqindësh ndaj produkteve me origjinë nga Serbia dhe Bosnja, por i menjëhershëm ka qenë reagimi i Qeverisë së Kosovës, duke përsëritur qëndrimin se taksa hiqet kur të na njohë Serbia



PRISHTINË, 10 DHJETOR - Shefja e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini, i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës ta revokojë taksën prej 100 përqindësh ndaj produkteve me origjinë nga Serbia dhe Bosnja. Mogherini ka thënë se u takon Kosovës dhe Serbisë se si do të duket marrëveshja finale mes tyre por, sipas saj, nuk do të pranohet kufi me linja etnike. "Ftoj Qeverinë e Kosovës ta tërheqë taksën. Nuk pranojmë kufi me linja etnike", ka thënë ajo. Këto komente Mogherini i bëri në një konferencë me gazetarë pas takimit të Këshillit të Punëve të Jashtme të BE-së në Bruksel. Por, qëndrimi i Qeverisë së Kosovës nuk ka ndryshuar sa i përket vendimit për taksën 100 për qind ndaj produkteve me origjinë nga Serbia

dhe Bosnja. Kabineti i kryeministrit Ramush Haradinaj, pavarësisht prej kërkesave të Federica Mogherinit, për ta tërhequr vendimin e taksës, ka bërë me dije se taksa hiqet vetëm kur Kosova ta pranojë njohjen nga Serbia. "Taksa hiqet kur kemi njohje nga Serbia. Kosova i ka argumentet e forta pse është vendosur kjo taksë. Nuk është respektuar marrëveshja e CEFTA-s dhe e gjithë kjo është bërë në mbrojtje të sovranitetit dhe ekonomisë së vendit", është thënë në reagimin e Qeverisë së Kosovës për "Klan Kosova".

Federica Mogherini tha të hënën se çfarëdo marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve që mund të arrijnë Kosovë dhe Serbia, përfshirë edhe kor-

rigjimin e mundshëm të kufijve, nuk bën të mbështetet në linja etnike. Ajo i bëri këto komente pas takimit të shefave të diplomacive të vendeve të Bashkimit Evropian, të cilët, pos të tjerash, diskutuan edhe për zhvillimet në Ballkanin Perëndimor, përfshirë edhe bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të cilat aktualisht kanë ngecur.

Mogherini tha se bisedimet janë në vështirësi, duke vënë theksin te tarifatat prej 100 përqindësh që

Qeveria e Kosovës u ka vënë mallrave nga Serbia dhe Bosnja, një veprim që nxiti reagimin e Beogradit i cili kushtëzoi vazhdimin e bisedimeve me heqjen e tarifave. Ajo sërish i bëri thirrje Prishtinës t'i heqë tarifatat, ndërsa shfaqti besimin se ende është e mundur të arrihet një marrëveshje ligjore gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve. Ajo marrëveshje, tha ajo, do të duhej t'i përfshinte të gjitha çështjet e hapura.

Mogherini tha se për Bashkimin Evropian është me rëndësi që ajo marrëveshje t'i respektojë parimet e së drejtës ndërkombëtare. "Më lejoni të them qartazi. Jo ndarje në vija etnike. Që të jem edhe më e qartë, çfarëdo 'korrigjimesh' që të dyja palët mund të diskutojnë në të ardhmen, marrëveshja nuk duhet të përfundojë me krijimin e shteteve etnikisht të pastra. Në çdo rast, të dyja vendet duhet të jenë shumetnike", tha Mogherini.

Protesta në disa qytete të Shqipërisë

TIRANË, 10 DHJETOR - Pas protestës gjashtëditore të studentëve, qytetarët janë ngritur në protesta të hënën pasdite në gjithë vendin. Në qytetet kryesore si Shkodra, Lezha, Kavaja, etj., janë me mijëra qytetarë që kanë dalë në rrugë.

Edhe pse është faza e parë e protestave dhe organizimi duket se ka qenë spontan, kërkesat e tyre kanë kryesisht karakter ekonomik. Ata kërkojnë uljen e çmimit të naftës. Kujtojmë se nafta në Shqipëri është më e lartë se në shumicën e vendeve të BE-së, ku të ar-



hura për frymë janë disa fish më të mëdha sesa për qytetarët shqiptarë. Protesta më masive ka qenë në

Shkodër, ku bashkë me qytetarët janë bashkuar dhe studentët e universitetit të këtij qyteti. Ata kanë kërkuar nga

kryeministri Edi Rama plotësimin e kërkesave ekonomike. Qytetarët në Shkodër deklaruan se protesta e sotme është vetëm fillimi. Edhe në Kavajë ka pasur një protestë masive kryesisht e biznesit të vogël dhe të mesëm, kundër rritjes së çmimit të naftës. Qytetarët kanë bllokuar rrugën Kavajë-Rrogozhinë. Kërkesat e përfaqësuesve të biznesit të vogël dhe të mesëm në Kavajë, janë:

të ulet çmimi i energjisë elek-

trike për 30 %; të ulet çmimi i karburantit 300 lekë për litër; të rritet pragu i TVSh-së për biznesin e vogël dhe të mesëm nga 20 mln lekë në vit që është sot, në 120 milionë lekë.

Edhe në Lezhë qytetarët kanë bllokuar rrugën dhe kanë hedhur parulla ekonomike dhe politike kundër qeverisë. Ndërkohë në Tiranë, veç studentëve, protesta ka edhe në dy zona të tjera. Ata që janë ngritur sot janë sërish banorët e "Unazës së Re", që kundërshtojnë prishjen e ndërtesave të tyre.

Ruçi takon Xhaferin: Problemet në rajon të zgjidhen me dialog

SHKUP, 10 DHJETOR - Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi, ka deklaruar në Shkup se Shqipëria mbështet anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, por ka theksuar edhe nevojën e realizimit të të drejtave të popullatës shqiptare. Ruçi në takimin me kryeparlamentarin Talat Xhaferi ka biseduar edhe për zhvillimet në rajon, me theks për raportet mes Kosovës dhe Serbisë, me ç'rast dy kryeparlamentarët theksuan

nevojën për zgjidhjen e problemeve përmes dialogut. "Përshëndetëm arritjet e Marrëveshjes së Prespës (Marrëveshja me Greqinë për emrin) dhe të gjitha përpjekjet që po bëhen në drejtim të ndërrimit të emrit, që do t'i hapë rrugën për anëtarësim në NATO dhe BE. I garantova kryetarit të Kuvendit mbështetjen e plotë të Shqipërisë për anëtarësim në NATO. Sigurisht një vend të rëndësishëm. zuri situata në

Ballkanin Perëndimor, me ç'rast nënvizuar se rruga e vetme për zgjidhjen e problemeve është dialogu. Shprehën shqetësimin e përbashkët për rritjen e tensioneve mes Serbisë dhe Kosovës. Shqipëria dhe Maqedonia po japin kontribut stabilizues për gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor", ka deklaruar kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi. Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi tha se

me homologun e tij nga Shqipëria kanë biseduan për proceset në Maqedoni për zbatimin e Marrëveshjes me Greqinë, bashkëpunimin mes dy vendeve, por edhe proceset në rajon. "Si dy vende fqinje bashkëpunojmë edhe në drejtim të integritetit të vendit në BE dhe NATO. Bashkë konstatuam se vetëm me dialog mund të përmbillen çështjet e hapura me fqinjët dhe se vetëm në këtë mënyrë mund të tejkalohen



problemet", deklaroi kreu i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi.

Ka filluar "Java Kundër Korrupsionit 2018"

Ambasadorët e Quintit: Të ndëshkohen zyrtarët e korrumpuar

Në hapje të "Javës Kundër Korrupsionit 2018", ambasadorët e vendeve perëndimore në Kosovës u kanë bërë thirrje institucioneve vendore të tregojnë vendosmëri për luftimin e korrupsionit. Në një tryezë të organizuar nga shoqëria civile ata kanë deklaruar se ligjet e miratuar për këtë fushë duhet të zbatohen, të ndëshkohen zyrtarët e korrumpuar dhe të mos ketë ndikim të politikës në gjyqësor

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Ambasadorët e vendeve të Quintit kanë ftuar institucionet e Kosovës të dëshmojnë se janë të gatshme t'i ndëshkojnë zyrtarët e korrumpuar. Në hapje të "Javës Kundër Korrupsionit 2018", të organizuar nga shoqëria civile, diplomatët perëndimorë kanë vlerësuar të hënën se ligjet e miratuara kanë efektin e duhur

vetëm kur të zbatohen ndaj të gjithëve në mënyrë të barabartë. Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Philip S. Kosnett, ka deklaruar se në Kosovë ka zyrtarë që marrin mito, punësojnë të afërm dhe ndërhyjnë në gjyqësor. "Ligjet e mira funksionojnë vetëm kur zbatohen në mënyrë të barabartë dhe drejt për të gjithë. Disa zyrtarë marrin mito, punësojnë të afërm dhe ndërhyjnë në gjyqësor ndërsa abuzojnë me detyrën e



tyre. Për keqardhje ka zyrtarë që shpesh japin interesin personal për të mirën e publikut", ka thënë Kosnett. Ai ka thënë se korrupsioni dëmton imazhin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. "Korrupsioni e njollos besimin e qytetarëve edhe nga jashtë. Qeveria tani duhet ta dëshmojë se është e gatshme t'i ndëshkojë zyrtarët e korrumpuar nga lart-poshtë. Kjo përkon në atë për shprehje të sinqertë", është shprehur Kosnett. Sipas tij, prijësit guximtarë duhet të jenë të gatshëm që ta pyesin veten nëse janë të gatshëm t'i shërbejnë Kosovës apo dikujt tjetër.

Edhe ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, Ruairi O'Connell, ka thënë se për ta luftuar korrupsionin nuk është i mjaftueshëm miratimi i ligjeve. Sipas tij, duhet të ketë trimëri brenda sistemit gjyqësor për ta luftuar këtë dukuri. "Nuk është e mjaftueshme të ketë ligje të mira, por të zbatohen. Duhet të ketë trimëri brenda sistemit gjyqësor që ta luftojnë korrupsionin. Kam përmendur disa herë emrin e Murat Mehmetit që ka parë gjatë punës së tij shkelje të ligjeve dhe ikjes nga tatimet. Lufta kundër korrupsionit është lufta e kosovarëve. Ka nevojë për trimëri nga zyrtarët, ka nevojë për mospraninë e qytetarëve për këto dukuri negative", është shprehur O'Connell.

Ai e ka ftuar politikën t'i ndalë ndërhyrjet në gjyqësor dhe punësimet e familjarëve. "Kur

Thaçi: Parandalimi i korrupsionit, hap jetik për forcimin e shtetit të së drejtës

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka vlerësuar se korrupsioni është armiku më i madh i një shoqërie demokratike. Në profilin e vet në "Facebook", Thaçi ka shkruar se aktivitetet në kuadër të "Javës Kundër Korrupsionit" janë shumë të rëndësishme për krijimin e një dinamike të re në luftën kundër kësaj dukurie negative. "Korrupsioni është armiku më i madh i një shoqërie demokratike dhe aktivitetet në kuadër të Javës Kundër Korrupsionit janë shumë të

rëndësishme për krijimin e një dinamike të re në luftën kundër kësaj dukurie negative. Kosova ka krijuar legjislacionin më modern në rajon dhe institucionet duhet ta kenë rolin dominues në luftën kundër korrupsionit, por gjithsesi se nevojitet angazhim i fuqishëm qytetar, që kjo luftë të sjellë rezultate më shumë. Funksionalizimi i tërë mekanizmave që merren me zhbërjen dhe parandalimin e korrupsionit është hap jetik për forcimin e shtetit të së drejtës", ka shkruar Thaçi.

Qeveria ndan mjete shtesë për prokurorët që luftojnë korrupsionin

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se prokurorët specialë që ndjekin rastet e korrupsionit do të marrin shtesa në pagë. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka bërë me dije se këtë vendim do ta marrë Qeveria të martën në mbledhjen e saj të rregullt. "Në Ditën Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit mund të krenohemi me ligjet e reja, që fuqizojnë sundimin e ligjit në fushën antikorrupsion. Me qëllim të zbatimit të këtyre ligjeve në praktikë, në mbledhjen e nesërme të Qeverisë do të vendosim për shtesë financiare në pagë për prokurorët specialë, me qëllim të fuqizimit të Prokurorisë Speciale, si hap i rëndësishëm për luftën kundër korrupsionit", ka shkruar Haradinaj, duke shtuar se për luftimin e korrupsionit sistemi i drejtësisë duhet të ndihmohet edhe nga qytetarët dhe shoqëria civile. "Prokurorët specialë, të cilët ndjekin këtë fushë, nga nesër do t'i kenë shtesat e pagës që do

t'ua japë atyre më shumë konfidencë, që t'i zbulojnë dhe ndjekin veprat e korrupsionit. Sistemit të drejtësisë duhet t'i vijë në ndihmë edhe qytetarët dhe shoqëria civile, duke bashkëpunuar ngushtë që në një të ardhme të afërt të jemi dëshmitarë se shteti i së drejtës do të triumfojë në këtë betejë", ka shkruar Haradinaj. Edhe ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, nëpërmjet një mesazhi me rastin e nisjes së "Javës Kundër Korrupsionit" ka ritheksuar përkushtimin e tij për të vazhduar jo vetëm në luftimin e korrupsionit, por edhe në masat konkrete për parandalimin e tij. Sipas tij, lufta kundër kësaj dukurie ka qenë një aktivitet i vazhdueshëm njëvjeçar i politikave të tij në krye të këtij dikasteri qeveritar. Tahiri ka bërë me dije se zyrtarët e korrumpuar do të përballen me dënime të larta ndërsa, pos ndjekjes penale, ai ka paralajmëruar se për këto vepra do të zbatohet edhe konfiskimi i pasurisë

flasim për politikanë që duan të ndërhyjnë në gjyqësor ne e dimë për kë po flasim. Po ashtu, edhe ata që punësojnë familjarë të vet e dinë për kë po flasim. E keni mbështetjen dhe përkrahjen e shteteve tona. Qytetarët e Kosovës nuk duhet të pranojnë gjërat që janë të papranueshme. Ne duam të ardhme të ndritshme për Kosovën siç kemi në vendet tona", ka deklaruar O'Connell.

Kurse ambasadori i Francës në Kosovë, Didier Chabert, ka vlerësuar se Kosova ka mungesë të ndëshkimeve të shërbyesve civilë që e kalojnë vijën e konfliktit interesit. "Kosova tashmë ka miratuar ligjet kyçe për konfliktin e interesit dhe mirësjelljen. Kosova tani është në vijë me prak-

tikat evropiane. Në raportin e fundit të BE-së është theksuar se konflikti i interesit ka shumë vështirësi për zbatimin e këtij ligji. Kemi mungesë të ndëshkimeve të shërbyesve civilë që e kalojnë vijën e konfliktit të interesit", ka thënë ambasadori francez.

Ndërkaq zëvendësambasadori i Gjermanisë, Jan-Axel Voss, ka vlerësuar se korrupsioni dëmton të gjitha projektet në të gjitha fushat. "Unë jam ekonomist dhe mendoj se korrupsioni ka të bëjë me lakminë që njerëzit të marrin nga të mirat publike. Korrupsioni dëmton të gjitha projektet në të gjitha fushat. E dëmton të ardhmen e të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe minon besimin e institucioneve", ka thënë Voss.

Promovohet katalogu me imazhe taktile dhe të përkthyer në Brail



PRISHTINË, 10 DHJETOR (ER) - Pënder të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, Muzeu i Kosovës ka promovuar katalogun me imazhe taktile dhe të përkthyer në Brail, në bashkëpunim me Shoqatën e të Verbërve në Kosovë. Me këtë rast ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, ka thënë se promovimi i këtij kat-

alogu është i rëndësishëm për personat e verbër. "Ky katalog sigurisht se promovohet me ju dhe përtej katalogut promovojmë bashkëpunimin e gjatë tuajin me Muzeun e Kosovës. Imazhet taktile të paraqitura në këtë katalog, përmes shqisës së prekjes, sjellin një pjesë të koleksionit të Muzeut më afër te personat e verbër dhe me dëmtime në

të parë", ka theksuar Gashi, duke vlerësuar se shkrimet në alfabetin e Brailit do t'u japin mundësi atyre të kuptojnë më shumë për historinë dhe tregimin e objekteve në Muzeun e Kosovës. Gashi është zotuar se MKRS-ja do të vazhdojë të përkrahë aktivitete të kësaj natyre dhe t'i gjendet afër edhe kësaj kategorie të njerëzve.

Flet për "Epokën e re", Zenun Pajaziti

Përfshirjen e presidentit në dialog du

- PDK-ja është për platformë gjithëpërfshirëse në dialog



Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, ka bërë me dije se ky subjekt politik e përkrah një platformë nga e cila del një ekip i përbashkët për dialogun me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se e mirëpret gatishmërinë e PSD-së për dialogun, por ka theksuar se çdo tendencë për ta penguar rolin kushtetues të secilit, qoftë edhe të presidentit të vendit, do të dështojë. Pajaziti ka thënë se përfshirja e presidentit me përgjegjësit e tij kushtetuese që ka duhet parë si avantazh për Kosovën, e jo të luftohet. Sipas tij, presidenti Thaçi është një prej protagonistëve kryesor në të gjitha proceset që ka kaluar Kosova. "Nëse dikush kalkulon me përjashtime ose me tendencën që nëpërmjet këtij procesi ta përjashtojë dikë, PDK-ja nuk është pro kësaj. PDK-ja është për përfshirjen e të gjithëve në vendimarrje", ka thënë Pajaziti

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 10 DHJETOR -

"Epoka e re": Z. Pajaziti, dy partitë e tjera të koalicionit qeverisës, AAK-ja dhe Nisma, kanë shprehur gatishmëri për ta përkrahur rezolutën dhe projektligjin e PSD-së për dialogun Kosovë - Serbi. Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) do t'i përkrahë këto dy dokumente?

Pajaziti: Partia Demokratike e Kosovës ka qenë dhe mbetet partia kryesore dhe insistuese që të ketë një platformë të përbashkët dhe një ekip të përbashkët për dialogun. Rrjedhimisht kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka pasur disa përpjekje të përsëritura për t'i ulur bashkë të gjithë faktorët

politikë në Kosovë, në mënyrë që të dalim sa më unikë në procesin e dialogut me Serbinë. Duke mbetur konsistentë në këtë ide, çdo iniciativë tjetër që vjen në këtë drejtim, PDK-ja e mirëpret dhe është e gatshme që të ulet t'i shqyrtojë në mënyrë që të jenë sa më gjithëpërfshirëse dhe në funksion të ecjes përpara. Pra, pavarësisht prej mosgatishmërisë së opozitës që ta pranojë idenë tonë për një platformë dhe ekip të përbashkët, ne jemi për t'i trajtuar të gjitha iniciativat që çojnë në drejtim të krijimit të një mekanizmi gjithëpërfshirës për dialogun.

"Epoka e re": Nuk e përjashtoni mundësinë që t'i mbështesni këto dy dokumente?

Pajaziti: Parapëlqejmë që në këto nisma dhe ide të përfshi-

het i gjithë spektri politik dhe PDK-ja është e hapur në këtë drejtim, pra që të ulen të gjithë dhe të nxjerrin një dokument të përbashkët dhe një ekip të përbashkët.

"Epoka e re": Çka është e pranueshme dhe çka e papranueshme për ju në këto dy dokumente?

Pajaziti: Nuk është se kemi marrë një qëndrim të caktuar. Për neve është e pranueshme të kemi vullnet të mirë dhe një platformë të përbashkët, në të cilën duhet të jetë i përfshirë i gjithë spektri politik në vend.

"Epoka e re": Me anë të kësaj rezolute dhe këtij projektligji parashihet kufizimi i presidentit për t'i udhëhequr bisedimet e Brukselit. Është PDK-ja e gatshme

het ta shohim si avantazh për vendin

institucione të rëndësishme kredibile të jenë të përfshira. Në rastin konkret, mendoj se askush nuk duhet të tentojë dhe të llogarisë që të bëjë llogari të tilla dhe aq më tepër kur kemi të bëjmë me personalitetin e presidentit i cili, përveçse është president i vendit, është një prej protagonistëve kryesor në të gjitha proceset. Pra, përfshirjen e tij me përgjegjësit e tij kushtetuese që i ka ne duhet ta shohim avantazh për vendin, e jo diçka që duhet të luftohet. PDK-ja e ka qëndrimin e qartë në këtë drejtim: Nëse dikush kalkulon me përjashtime ose me tendencën që përmes këtij procesi ta përjashtojë dikë, gjithsesi PDK-ja nuk është pro kësaj. PDK-ja është për përfshirjen e të gjithëve në vendimmarrje, të gjithë atyre që kanë përgjegjësi kushtetuese dhe politike në këtë vend. Përveç presidentit që e ka rolin e vet, parapëlqejmë të jenë të përfshirë edhe partitë opozitare.

"Epoka e re": Përderisa LDK-ja dhe Vetëvendosje janë kategorikisht kundër, PSD-ja ka shprehur të jetë pjesë e këtij procesi, por me kushtin që presidenti Thaçi të jetë i kufizuar. Mund të dështojë kjo përpjekje meqë ju nuk jeni të gatshëm për këtë lloj kufizimi?
Pajaziti: Propozimi i PSD-së është i mirë dhe nuk do të duhej të dështonte. Ata që rrinë anash duke i fërkuar duart se kanë një mundësi për ta përjashtuar dikë duhet të dinë qysh tash se nuk ka shpresë dhe nuk duhet të tentojë dikush ta devalvojë idenë e mirë të PSD-së që të kontribuojë pozitivisht në proces. Ne e trajtojmë me respektin dhe seriozitetin më të madh idenë e PSD-së.

"Epoka e re": Ju po e konsideroni të mirë këtë ide, në të njëjtën kohë po thoni se nuk jeni për kufizime, edhe pse rezoluta e PSD-së e parasheh një gjë të tillë.
Pajaziti: Po e përsëris, çdo tendencë për ta penguar rolin kushtetues të secilit do të dështojë, sikundër edhe çdo tendencë për të bërë zgjidhje jokushtetuese. Personalisht mendoj dhe besoj se PSD-ja nuk e ka një tendencë të tillë.

"Epoka e re": Një gjë të tillë e ka thënë deputeti i PSD-së, Dukagjin Gorani.
Pajaziti: Nëse PSD-ja përfshihet në një gjë të tillë me siguri se nuk mund ta çojë përpara idenë e vet. Nuk besoj se PSD-ja e ka idenë e tillë dhe ne nuk duhet të paragjykojmë.

Iniciativa e tyre duhet të vazhdohet sepse është një përpjekje e mirë për t'u ulur të gjithë në një ekip i cili do të ishte përfaqësues i institucioneve tona në procesin e dialogut.

"Epoka e re": Si e shihni vazhdimin e procesit të bisedimeve Kosovë - Serbi dhe a mendoni se do të mund të arrihet konsensusi për këtë çështje pas këtyre zhvillimeve?
Pajaziti: Ky është një prej proceseve më të vështira që kemi pasur vitet e fundit në vendin tonë. Është një ndër përgjegjësit më serioze që del para politikës së Kosovës. Shpresoj se do të gjendet forcë dhe pjekuri e nevojshme politike e të gjithëve në mënyrë që ky proces të ecë më tutje. Tekefundit, nuk kemi një alternativë tjetër. Edhe ata që e kanë kundërshtuar dhe mund ta kundërshtojnë këtë proces

nuk është se kanë pasur ose e kanë një koncept ndryshe për të prezantuar një plan tjetër se si duhet të ecet në këtë drejtim. Dialogu është instrumenti me të cilin ne duhet t'i zgjidhim të gjitha problemet dhe aq më tepër se duhet t'ia hapim rrugën vendit tonë në proceset integruese.

"Epoka e re": Z. Pajaziti, si e komentoni kërkesën e LDK-së dhe të Vetëvendosjes për zgjedhje të reja? Ka zgjidhje tjetër përveç zgjedhjeve?
Pajaziti: Është kërkesë joserioze për vetë faktin se bëhet pikërisht në kohën kur duhet t'i marrim përgjegjësitë të gjithë për t'u përfshirë në këtë proces. Mendoj se kjo është më shumë ikje nga përgjegjësia që e kanë sesa që është ide për të pasur zgjidhje të duhur. Nëse ata nuk janë në gjendje të japin një plan ose

ide se si duhet të bëhet, nuk besoj se në një rast tjetër të tillë do të mund të merrnin përgjegjësi të tjera e do ta kishin fuqinë dhe seriozitetin e duhur të merren me këtë proces shumë serioz dhe për fatin e vendit dhe të gjeneratave që do të vijnë.

"Epoka e re": Do të jetë sfidues vazhdimi i funksionimit të koalicionit qeverisës dhe puna e Kuvendit të Kosovës në këto rrethana?

Pajaziti: Përgjegjësinë që kanë marrë përfaqësuesit institucionalë me votën e lirë të qytetarëve duhet ta kryejnë sa më mirë. Institucionet duhet të fokusohen më shumë në kualitetin e qeverisjes dhe në problemet që i kanë qytetarët. Kjo është përgjegjësia që kanë përfaqësuesit e institucioneve. Pjesa tjetër do të shihet në sfidat që do të vijnë.

Adem Demaçi ishte edhe simbol i rezistencës politike

PRISHTINË, 10 DHJETOR (ER) - Kolegji AAB, në shënim të 10 dhjetorit, Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut, në bashkëpunim me KMDLNJ-në ka organizuar të hënën një tryezë kushtuar veprimtarit të shquar Adem Demaçi. Me këtë rast, rektori i Kolegjit AAB, Lulzim Tafa, ka thënë se kjo tryezë i kushtohet simbolit të rezistencës dhe përpjekjeve tona për liri, Adem Demaçit. "Në sakrificën e Adem Demaçit edhe Evropa dhe bota demokratike është ndërgjegjësuar më shumë. Sakrifika e tij na bëri që ne sot ta jetojmë lirinë dhe pavarësinë. Për shkak të vuajtjeve të tij bota e quajti Mandela i Evropës, kurse Parlamenti Evropian e nderoi me Çmimin Saharov", u shpreh rektor Lulzim Tafa.

Në këtë shënim të 70-vjetorit të nënshkrimit të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut, vepra e simbolit të rezistencës kosovare u përmend në disa dimensione, si atë letrare, politike dhe njerëzore. Duke folur për Demaçin, Agim Vinca, njohës i mirë i letërsisë, ka thënë se Demaçi në radhë të parë njihet si veprimtar politik, por ai është edhe veprimtar për të drejtat e njeriut dhe shkrimtar. "Nuk duhet harruar këtë sepse ndonjëherë veprimtaria e tij politike, burgu, qëndresa, idealizmi i tij, lënë mbase pa të drejtë nën hije këtë aspekt të veprimtarisë së tij", u shpreh Vinca. Ndërsa Hajredin Kuçi u shpreh se Adem Demaçi ishte edhe simbol i rezistencës politike. "Rrallë ndonjë personalitet në

histori kombëtare dhe botërore shndërrohet për një periudhë shumë të shkurtër, frymëzues për breza të tjerë. Nuk ka lëvizje kombëtare, që nga viti 1954, edhe më tutje, që mendjen, emrin dhe zemrën e Adem Demaçit s'e ka pasur në përdorim, madje edhe ata që nuk e kanë njohur fare", u shpreh Kuçi.

Pjesë e kësaj tryeze ishin edhe Behxhet Shala nga KMDLNJ-ja dhe historiani Hakif Bajrami të cilët theksuan se Adem Demaçi do të jetë gjithmonë në jetët tona dhe do të përkujtohet gjithmonë. Adem Demaçi njihet si veprimtar politik i cili ka marrë shumë çmime. Ai ishte fitues i Çmimit Saharov dhe çmimeve të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.



që ta kufizojë Thaçin në këtë aspekt?

Pajaziti: Kemi qenë të qartë gjatë gjithë kohës se këto procese nuk duhet t'i ngatërrojmë me individët dhe udhëheqës të institucioneve apo partive politike. Në këtë drejtim jemi të vendosur që të mos lejojmë që proceset e tilla të kenë tendencë përjashtuese ose qërim hesapësh të brendshme, aq më tepër kur kemi të bëjmë me institucione të rëndësishme dhe me personalitete që kanë përgjegjësi kushtetuese në proces. Rrjedhimisht, nëse dikush ka tendencë të tilla, me siguri se PDK-ja nuk do të lejojë përjashtime ose tendencë përjashtuese në kohën kur ne duhet të jemi të gjithë bashkë dhe në kohën kur ne kemi nevojë që personalitete dhe

Grabovci: Kam pritur të jem në listat e shërbimit serb për likuidim, por kurrë në listat e shqiptarëve

PRISHTINË, 10 DHJETOR- Ish-deputeti nga radhët e PDK-së, Adem Grabovci, ka dëshmuar në rastin e plagosjes së avokatit Azem Vllasi në gjykimin e njohur si 'Syri i Popullit'. I njëjti duke u përgjigjur në pyetjet e prokurorit special Sylë Hoxha, pasi që u pyet lidhur me organizatën "Syri i Popullit", dëshmitari Adem Grabovci tha se për këtë organizatë ka dëgjuar vetëm përmes medieve.

Ai gjatë kësaj dëshmie rrëfeu për marrëdhënien e tij miqësore të paraluftës në mes tij, Murat Jasharit dhe familjes së tij. "Po, e njoh Murat Jasharin, diku prej vitit 1991 kur kam emigruar në Zvicër kam qenë kryetar i Lëvizjes Popullore, Dega në Zvicër, Murat Jashari ka qenë aktivist i lëvizjes popullore të Kosovës dhe atje jemi njohur me të dhe familjen e tij për të cilën gëzoj një respekt të jashtëzakonshëm", tha Grabovci, raporton "Kallxo.com".

Kurse për periudhën e pas luftës ai tha se nuk e di saktë nëse ka pasur më kontakte me Muratin por tha se në kujtesë e mban kohën e paraluftës dhe raportet e mira që kanë pasur në mes

vete në atë kohë. "Pas luftës nuk e di që kam pasur kontakte me Muratin nuk e di, megjithatë po të kishte kërkuar sigurisht që do të isha takuar...Unë e mbaj kujtesën e mirë vetëm për para luftës, raportet tona kanë qenë edhe familjare është vëllai i dëshmorit/heroit të kombit me të cilin kemi qenë në luftë bashkë", tha Grabovci.

Lidhur me pyetjet të cilat i akuzuari Murat Jashari përmes disa medimeve i kishte drejtuar deputetit Adem Granovci, ky i fundit lidhur me këtë tha se këto pyetje i kishte injoruar pasi që i ishin dukur qesharake dhe sipas tij të manipuluar.

Për arsyen se pse emri i tij është gjendur në emrin e personave të listuar për likuidim, Grabovci tha se nuk e ka idenë se pse emri i tij është gjendur në atë listë pasi që deklaroi se ai në vazhdimësi gjithnjë është munduar të kontribuojë për vendin dhe se asnjëherë nuk e ka kursyer veten në këtë drejtim.

"Edhe nga familja e kam traditën e tillë por edhe vetë nuk e besoj që e kam kursyer vetveten për të kontribuar për të mirën e popullit tim, i kam kaluar të gjitha sfidat edhe burgjet e ish-



sistemit jugosllav edhe angazhimin në ilegale edhe përgatitjen për luftë edhe organizimin për luftë edhe si një nga ish-udhëheqësit e luftës, e di që në listat e UDB-së kam qenë por nuk e besoj që ndonjë shqiptari i kam bërë keq e as që kam menduar keq por gjithnjë kam bërë përpjekje që maksimumin tim ta jap t'i ndihmoj dhe aty ku kam vlerësuar se ka nevojë për angazhimin tim nuk jam kursyer dhe nuk kursehem. Pse jam në atë listë edhe për mua është një pikëpyetje e madhe", ka deklaruar Grabovci.

Lidhur me pretendimet nëse Murat Jashari mund të ketë qenë i manipuluar nga ndokush,

Grabovci tha se ai e njoh Murat Jasharin e paraluftës ndërsa për Murat Jasharin e pasluftës tha se nuk dëshiron të komentojë.

Grabovci tha se asnjëherë nuk i është frikësuar e as nuk i frikësohet Murat Jasharit pasi që, sipas tij, ai nuk mund ta besojë se emri i tij mund të gjendet në një listë për likuidim, listë e cila mund të ketë qenë e përpiluar nga Murat Jashari. "Murat Jashari nuk i jam frikësuar kurrë nuk i frikësohem as tash, ajo familje edhe në 12 të natës e ka derën hapur sepse logjika ime nuk e kap që unë të gjendem në listën për likuidim të Murat Jasharit edhe këtu prapë po e them se kush qëndron prapa nuk e di", deklaroi

Grabovci.

Për dy sulme dhe kërcënime të cilat tha se i ka pasur, Grabovci deklaroi se ai beson se këto sulme nuk kanë pasur të bëjnë me të akuzuarin Murat Jasharin pasi që tha se më të dhe familjen e tij gjithëherë i ka pasur raportet e mira. "Unë kam pasur dy sulme dhe kërcënime, djegien e makinës dhe për letrën kërcënuese që më është gjendur në banesë, a ndërlihet a nuk ndërlihet nuk e di por lidhur me Murat Jasharin i kam raportet e qarta dhe kurrë nuk mund të gjendem në listën e Murat Jasharit për likuidim, nuk ka kush më bind e kush qëndron prapa nuk e di", u shpreh ish-deputeti Adem Grabovci. Në fund Grabovci tha se ai ka pritur që emri i tij të gjendej në listat e shërbimeve serbe për likuidim por asnjëherë në lista të përpiluar nga shqiptarët. "Askush nuk ndjehet komod, për mua ka qenë e papritur. Kam pritur, pres të gjendem në listat e shërbimit serb për likuidim por kurrë në listat e shqiptarëve sepse kam shërbyer maksimalisht për të mirën e vendit", shtoi Grabovci. Prokuroria Speciale ngriti aktakuzë ndaj 10 personave në lidhje me këtë rast më 28 shkurt.

LDK-ja: Të rinjtë po përballen me kushtëzimin e përvojës së punës

PRISHTINË, 10 DHJETOR (ER) - Forumi i Rinisë i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) ka mbajtur të hënën konferencën me temë "(Pa)siguria sociale dhe ekonomike e të rinjve në Kosovë". Konferencën e ka hapur kryetari i Forumit të Rinisë së LDK-së, deputet i Kuvendit të Kosovës, Fidan Rekalii, i cili ka folur për sfidat e të rinjve. Po ashtu, Rekalii ka folur për rezolutën për rininë e miratuar në Kuvend dhe nga të pranishmit ka kërkuar komente dhe sugjerime për ta plotësuar. Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës ka folur nënkryetari i kësaj partie, Agim Veliu, i cili ka vlerësuar rolin e rinisë si pjesë e proceseve tepër të rëndësishme për



LDK-në dhe Kosovën. Veliu ka theksuar sfidën primare të të rinjve të porsadiplomuar që dalin në tregun e punës, ku shpeshherë ata përballen me aspektin ligjor, ku kushtëzohen me përvojë pune paraprake së paku dy deri në tri vjet.

Nënkryetari Veliu ka folur për politikën e dëmshme të Qeverisë aktuale, si sfida shumë të mëdha për vendin tonë, të cilat përmes punës dhe politikave të LDK-së në qeverisjen e ardhshme do të tejkalohen, përkundër dëmeve që po bëhen

në qeverisjen aktuale. Ai ka ofruar përkrahje dhe ka premtuar përfshirje dhe organizim të rinisë përmes grupeve punuese të ekspertëve të fushave të ndryshme në LDK, në procese të cilat kontribuojnë për ndryshimin dhe zhvillimin e

vendit.

LDK-ja në qeverisjen e saj ka paraparë program të qartë dhe konkret për zhvillimin e rinisë. Veliu ka kërkuar nga Forumi i Rinisë, si organizata më e madhe që, pavarësisht prej politikave, të luftojnë shumë për përmirësimin e jetës së tyre. Gjatë kësaj konference për sfidat e të rinjve, për politikën e mirëfillta dhe faktorë që ndikojnë te rini, kanë folur edhe ish-ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, Jehona Lushaku, profesoreshë në Fakultetin Filozofik në Departamentin e Shkencave Politike dhe Vehbi Kajtazi nga Këshilli i Ekspertëve për Kulturë, Rini dhe Sport i LDK-së.

Seanca për transformimin e FSK-së mbahet të premten në orën 10:00

Prishtinë, 10 dhjetor (ER) - Seanca e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në të cilin pritet të miratohen tri projektligjet për transformimin e Forcës së

Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri, do të mbahet të premten në orën 10:00. Në këtë seancë do të shqyrtohet në lexim të dytë Projektligji për Ministrinë e

Mbrojtjes, ai për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligji për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Liderët institucionalë të Kosovës kanë përsëritur se ush-

tria e Kosovës do të jetë ushtri e paqes në Ballkan, por edhe në zona të tjera kudo që do të kërkohej angazhimi i saj për ruajtjen e paqes.



Ministri Ismaili: Ndalëm korrupsionin në blerjen e barnave

"Për vite me radhë janë keqpërdorur miliona euro të buxhetit të shtetit për blerjen e barnave me çmime të fryra. Ne po i themi stop korrupsionit. Vetëm për një vit shpëtuan gjashtë milionë euro, blemë më shumë barna, aparatura mjekësore dhe ndërruam shtretërit në QKUK", kështu ka thënë të hënën, në një konferencë për media, ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka mbajtur të hënën një konferencë të jashtëzakonshme për media, në të cilën ka folur për luftimin e korrupsionit dhe keqmenaxhimin për blerjen e barnave e cila ka ndodhur për disa vjet me radhë. Në këtë konferencë ministri Ismaili ka bërë publike dëshmi të cilat tregojnë se për shumë vjet janë blerë barna me çmime shumëfish më të shtrenjta. Me këtë rast, ai ka thënë se gjatë vitit 2018, kjo praktikë jo vetëm se është ndalur, por edhe janë blerë gjashtë milionë euro më lirë barnat e njëjta me të njëjtën sasi sesa në vitet paraprake. "Për vite me radhë janë keqpërdorur miliona euro të buxhetit

të shtetit për blerjen e barnave me çmime të fryra. Por, ne po i themi stop korrupsionit. Vetëm për një vit shpëtuan gjashtë milionë euro, blemë më shumë barna, aparatura mjekësore dhe ndërruam shtretërit në QKUK", ka thënë ai. Më tej, ministri Ismaili ka marrë shembull vetëm njërin nga barnat i cili përdoret për trajtimin e pacientëve të sëmurë nga kanceri dhe leukemia për ta dëshmuar keqpërdorimin e madh të buxhetit të shtetit që ka ndodhur. "Korrupsioni i lartë në institucione varfëron me mijëra familje poshtë. Duke e goditur korrupsionin, ne kemi kursyer qytetarët. Kjo më së miri mund të shihet në rastin e Imatinibit, një ilaç kundër sëmundjes së kancerit dhe leukemisë. Në vitin 2016 imatinibi është blerë

për 652 mijë euro, ndërsa sasinë e njëjtë e kemi blerë për 75 mijë euro. Do të thotë, vetëm për një kontratë ne kemi shpëtuar 577 mijë euro. Kjo është politika jonë dhe do ta vazhdojmë deri në transformim radikal të shërbimeve shëndetësore, derisa institucioneve tona, mjekëve dhe qytetarëve t'u kthehet dinjiteti profesional

dhe njerëzor", ka thënë Ismaili. Duke folur për parandalimin e kësaj dukurie, ministri Ismaili ka theksuar Ministria e Shëndetësisë, nën udhëheqjen e tij, nuk do të blejë më barna më shtrenjtë sesa vendet e rajonit. "Këtë kapitull të keqpërdorimit të parave po e mbyllim këtë vit. Puna jonë nuk ka mbaruar. Do t'i vazhdojmë

veprimet e tjera që ruajnë buxhetin e shtetit dhe të qytetarëve. Ky është vetëm viti i parë, por unë sot shoh optimizëm edhe te qytetarët, edhe te punëtorët shëndetësorë. Te ta shihet një gatishmëri më e madhe për të qenë pjesë e luftës sonë për përmirësimin e shëndetësisë", ka thënë ministri Ismaili.

Mbi 600 zyrtarë të lartë publikë mbajnë më shumë se një pozitë

PRISHTINË, 10 DHJETOR (ER) - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) të hënën ka mbajtur tryezën "Zbatimi i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik në sistemin e drejtësisë", si aktivitet në kuadër të "Javës Kundër Korrupsionit 2018". Në këtë tryezë u publikua raporti i përbashkët i koalicionit të OJQ-ve me titull "Parandalimi dhe luftimi i konfliktit të interesit në Kosovë", lidhur me të gjitha aspektet e qëllimit të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe zbatimin e këtij ligji nga pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. IKD-ja ka prezantuar gjetjet e hulumtimit në lidhje me zyrtarët e pushtetit gjyqësor, të cilët mbajnë më shumë se një pozitë. Kuvendi i Kosovës, në pajtim me obligimet e marra lidhur me plotësimin e kriterëve që dalin nga Agjenda e Reformës Evropiane, kishte miratuar Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit për Ushtrimin e Funksionit Publik, i cili ligj, më 20 prill 2018, ishte dekretuar nga presidenti i Republikës së Kosovës. Ligji është publikuar në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës

më 27 prill 2018 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit, respektivisht më 12 maj 2018. Në tryezë u bë me dije se koalicioni "Java Kundër Korrupsionit 2018", nga analiza dhe hulumtimi i afërsisht 4 000 zyrtarëve të lartë publikë, ka identifikuar se 659 zyrtarë të lartë publikë mbajnë më shumë se një pozitë. Prej 659 personave që mbajnë më shumë se një pozitë, koalicioni ka identifikuar 581 zyrtarë që mbajnë nga dy pozita, 63 zyrtarë kanë nga tre pozita, 10 zyrtarë nga katër pozita si dhe pesë zyrtarë kanë nga pesë pozita. IKD-ja ka paraqitur kërkesa për qasje në dokumente publike lidhur me listat e pagave të zyrtarëve publikë dhe të dhënat ku përfshiheshin pagat, kompensimet, mëditjet, shtesat dhe çdo shpenzim tjetër në kuptim të shpërblimit me pagesë të zyrtarëve të lartë publikë në sistemin gjyqësor, prokurorial dhe Akademinë e Drejtësisë, por që ka marrë përgjigje vetëm nga kjo e fundit. Si pasojë e kësaj, IKD-ja ka qenë i obliguar që analizën dhe hulumtimin ta bazojë përmes analizimit dhe nxjerrjes së informatave prej formularëve të deklarimit të pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit.



Prej 631 zyrtarëve të lartë publikë që ushtrojnë funksione publike në sistemin gjyqësor, prokurorial dhe akademinë e drejtësisë, ku përfshihen anëtarë të Këshillit Gjyqësor, anëtarë të Këshillit Prokurorial, gjykatës, prokurorë dhe shërbyes civilë, IKD-ja ka identifikuar një prokuror dhe një gjykatës që ushtrojnë në të njëjtën kohë pesë funksione, një prokuror dhe tre gjykatës që ushtrojnë

katër funksione, 13 zyrtarë të sistemit prokurorial dhe 11 zyrtarë të sistemit gjyqësor që ushtrojnë tre funksione dhe 38 zyrtarë në sistemin prokurorial dhe 23 zyrtarë në sistemin gjyqësor që ushtrojnë nga dy pozita. Gjatë tryezës, panelistët dhe pjesëmarrësit debatuan me fokus në tri çështje kryesore: numrin e pozitave publike që mund t'i ushtrojnë zyrtarët e sektorit të drejtësisë, kompensi-

mi financiar i zyrtarëve publikë dhe qasja në dokumente publike. Panelistët e kësaj tryeze vlerësuan se personat publikë është më mirë të mbajnë një punë dhe të njëjtën ta kryejnë mirë sesa të mbajnë disa pozita dhe të mos ketë produktivitet. Sipas tyre, aty ku ka konflikt të interesit, aty humbet besimi i qytetarëve në sistemin e drejtësisë dhe duhen shumë vjet që të rikthehet ai besim.

Thaçi e Minxhozi diskutojnë për bashkëpunimin në sektorin e energjisë elektrike



Drejtori menaxhues i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Njazi Thaçi, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin e dy korporatave shqiptare, Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) dhe Korporatës Energjetike Shqiptare (KESH), në fushën e shkëmbimit të energjisë elektrike dhe për mundësitë e reja për rritjen e bashkëpunimit

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Drejtori menaxhues i Korporatës Energjetike të Kosovës, Njazi Thaçi, ka pritur në takim ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi. Në këtë takim është biseduar për bashkëpunimin e dy korporatave shqiptare, Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) dhe Korporatës Energjetike Shqiptare (KESH) në fushën e shkëmbimit të energjisë elektrike dhe për mundësitë e reja për rritjen e bashkëpunimit. Drejtori menaxhues i KEK-ut, Njazi Thaçi, e ka njoftuar ambasadorin se ndër vite është ndërtuar një bashkëpunim vëllazëror në mes të KEK-ut dhe KESH-it, duke u respektuar të gjitha normat juridike dhe rregullat e tregut, njëkohësisht

duke qenë në interes të dy shteteve dhe qytetarëve. "E kemi thënë edhe më herët, duhet ta përsërisim edhe tash, se bashkëpunimi në mes të KEK-ut dhe KESH-it ndoshta duhet të vlejë si shembulli më i mirë i bashkëpunimit në mes të dy shteteve tona. Kemi ndërtuar partneritet të mirëfilltë, vëllazëror, në interes të qytetarëve dhe pa i dëmtuar në asnjë rast interesat e dy korporatave. Në çdo situatë u përgjigjemi kërkesave të njëri-tjetrit dhe i ofrojmë bashkëpunim në shkëmbim të energjisë elektrike, bazuar në kapacitetet që kemi në dispozicion. Ky bashkëpunim, pra shkëmbimi i energjisë elektrike, në rastet kur kemi mungesa të mëdha njëra palë dhe ka kapacitete tepërcë, pala tjetër shkëmbehet 1 MW/h me 1MW/h, pra aq sa marrim sasi e kthejmë dhe anasjelltas.

Kjo formë e bashkëpunimit nuk e dëmton asnjërin palë dhe është në interes të të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës", ka thënë Thaçi në këtë takim me ambasadorin e Shqipërisë, Qemal Minxhozi. Ndërsa ambasadori Minxhozi e ka falënderuar drejtorin e KEK-ut për pritjen dhe për punën e shkëlqyer që po bëhet në mes të dy korporatave. Ai ka shprehur gatishmërinë për ta thelluar këtë bashkëpunim. Ambasadori Minxhozi gjatë këtij takimi ka shprehur gatishmërinë për të përkrahur edhe iniciativa apo projekte të reja që janë në interes të dy vendeve në sektorin e energjisë elektrike. Ndër të tjera, është biseduar edhe për mundësitë e financimit të bashkët, Kosovë - Shqipëri për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese.

Kapen pije joalkoolike duke u kontrabanduar nga Serbia



PRISHTINË, 10 DHJETOR (ER) - Oficerët doganorë kanë arritur të kapin një furgon të ngarkuar me pije joalkoolike që dyshohet se janë kontrabanduar nga Serbia. "Rreth orës 11:00 njësitet e Doganës kanë ndaluar një veturë për kontroll të detajuar, e drejtuar nga një shtetas kosovar/shqiptar. Gjatë kontrollit janë gjetur të ngarkuara sasi të mëdha të pijeve joalkoolike: Coca cola 1 072 litra, Fanta 160 litra, si dhe Shweppes 60 litra. Malli nuk

kishte asnjë dokumentacion dhe i njëjti është me origjinë nga Serbia, pra dyshohet të jetë kontrabanduar. Vetura dhe mallrat janë konfiskuar deri në përfundimin e procedurës kundërvajtëse. Dogana fton të gjithë qytetarët që hasin këso mallra t'i lajmërojnë institucionet pasi, përveç që janë të kontrabanduara, nuk kanë të kaluar asnjë kontroll në aspektin e cilësisë", është thënë në njoftimin e Doganës së Kosovës.

Rritet kostoja e ndërtimit


PRISHTINË, 10 DHJETOR (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar indeksin e çmimeve të ndërtimit për tremujorin e tretë të këtij viti, ku vlerësohet se indeksi i tërësishëm i kostonë së ndërtimit në Kosovë pati ngritje për 0.5 për qind, kra-

hasuar me tremujorin e dytë të këtij viti (TM2). Sipas ASK-së, rritje më të madhe kishte te kategoritë: transporti 14.3 për qind, energjia 1.6 për qind dhe kostot e tjera 0.6 për qind. "Krahasuar të njëjtën periudhë, TM3 2018 me atë të vitit paraprak, TM3 2017,

Indeksi i Kostos së Ndërtimit pati ngritje prej 2 përqindësh. Ngritja e indeksit kryesisht u vërejt te kategoritë: transporti 14.3 për qind, energjia 2.5 për qind, materialet 2.1 për qind dhe kostot e tjera 1.3 për qind", thuhet në njoftimin e ASK-së.



Haradinaj: Qeveria do ta rrisë partneritetin privat



Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se Qeveria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për përkrahje të prodhuesve vendorë. Ai ka theksuar përkushtimin që edhe më tutje t'i vazhdojë reformat e përgjithshme me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, fuqizimit të sektorit privat dhe krijimit të një klime të favorshme për biznese

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të hënën në takim përfaqësuesit e Odës së Afarizmit të Kosovës, të

udhëhequr nga kryetari i bordit, Skender Krasniqi, me të cilët ka biseduar për zhvillimin ekonomik, fuqizimin e partneritetit ndërmjet institucioneve, odave dhe sektorit privat në përgjithësi.

Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se Qeveria

ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për përkrahje të prodhuesve vendorë. Ai ka theksuar përkushtimin që edhe më tutje t'i vazhdojë reformat e përgjithshme me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, fuqizimit të sektorit privat dhe krijimit të një klime

të favorshme për biznese. Gjatë takimit është diskutuar edhe për taksën e vendosur nga Qeveria e Kosovës për masën prej 100 përqindësh ndaj produkteve të importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, për të cilën kryeministri Haradinaj tha se kjo është përgjigje ndaj veprimeve të vazhdueshme destruktive të Serbisë dhe Bosnje dhe Hercegovinës ndaj subjektivitetit dhe sovranitetit të Kosovës.

Përfaqësuesit e Odës së Afarizmit të Kosovës i kanë shpallur para kryeministrit

Haradinaj një listë të kërkesave të tyre karshi Qeverisë së vendit, për të cilat kryeministri Haradinaj u zotua që do të angazhohet për adresimin e tyre. Përfaqësuesit e Odës së Afarizmit të Kosovës po ashtu falënderuan kryeministrin Haradinaj për përkrahjen që po i jep zhvillimit të sektorit privat dhe prodhuesve vendorë përmes lehtësirave tatimore, duke shprehur përkrahjen për taksën 100 për qind për produktet nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina, e cila, sipas tyre, do t'i fuqizojë bizneset dhe prodhuesit vendorë.

MMPH-ja dhe GIZ-i gjerman me gjashtë projekte për mjedisin

Prishtinë, 10 dhjetor (ER) - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, së bashku me sekretarin Arben Çitaku dhe këshilltarët politikë, të hënën janë takuar me sekretaren e parë të Ambasadës Gjermane në Kosovë, Anja Becky dhe përfaqësuesit e GIZ-it gjerman.

Gjatë këtij takimi është diskutuar për gjashtë projekte që qeveria gjermane nëpërmjet GIZ-it po i realizon së bashku me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Këto projekte, që kanë synim përmirësimin e mjedisit, kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave, ujërat dhe vërshimet,

planifikimin hapësinor, energjinë efiçente, reformat ligjore dhe biodiversitetin. Me këtë rast, ministri Matoshi ka thënë se mbështetja e Qeverisë Gjermane përmes këtyre gjashtë projekteve është vullnet për ndryshime pozitive të mjedisit dhe planifikimit hapësinor në vend.



100 familjeve me asistencë sociale në Kastriot u shpërndahen pako ushqimore

KASTRIOT, 10 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Kastriotit, Xhafer Gashi, ka bërë me dije se të hënën kanë bërë shpërndarjen e pakove ushqimore për 100 familje me asistencë sociale në këtë komunë. Me këtë rast, Gashi ka falënderuar dy kompani vendore të cilat kanë qenë kontribuuese të këtij aksioni humanitar. "Për ta falënderuar për zëmërisht për ndihmën e tyre bërë komunitetit tim, sot, bashkë me për-

faqësuesit nga kompania 'Zero Positive' dhe 'Stone Castle', u bashkëngjita në aksionin humanitar, me ç'rast bëmë shpërndarjen e pakove ushqimore për më shumë se njëqind familje me asistencë sociale, duke u lehtësuar sadopak ditët e tyre të jetesës. Uroj të kemi sa më pak raste të tilla, ndërsa respekt për njerëzit humanitarë dhe kontribuuesit në shoqërinë tonë", ka thënë Gashi.



Hoti nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi edhe me Komunën e Klinës

KLINË, 10 DHJETOR (ER) - Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Kosovës, Rexhep Hoti, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kryetarin e Komunës së Klinës për realizimin e Programit Nacional për Rininë. "Programi Nacional për Rininë është një program i har-

tuar ekskluzivisht për 340 000 nxënës dhe 110 000 mijë studentë i cili do t'u krijojë atyre hapësirën që deri më tani u ka munguar. Do të ndahen mbi 100 000 shpërblime për një vit. Pra, për fituesit e vendeve të para do të ketë shpërblime të ndryshme. Përmes këtij programi synojmë ta ndalim shpërnguljen e të rin-

jve", ka thënë Hoti. Koordinatori Hoti ka deklaruar se programi ka për qëllim avancimin e pozitës së të rinjve në sport, kreativitet kulturor dhe mendim kritik si dhe në dituri. Kryetari Elezaj ka thënë se është shumë i lumtur që më në fund një program gjithëpërfshirës është miratuar nga Qeveria.



Komuna e Prishtinës bën thirrje për parandalimin e djegies së kontejnerëve

PRISHTINË, 10 DHJETOR (ER) - Komuna e Prishtinës u ka bërë thirrje bizneseve dhe amvisërive që mbetjet e djegieve (hirin) të mos i hedhin në kontejnerët e plastikës për shkak të dëmeve që po i shkaktojnë. "Mbetjet e djegieve,

vetëm pasi të ftohen, duhet të hedhen në thasë të plastikës dhe të vendosen pranë kontejnerëve. Kompania 'Pastrimi' do ta bëjë largimin e tyre. Djegia e kontejnerëve, përveçse po shkakton dëme materiale, paraqet rrezik edhe për mje-

disin përreth. Drejtorja e Inspeksionit në bashkëpunim me Policinë e Kosovës do ta mbikëqyrin këtë proces dhe, kudo që e identifikojnë shkaktarin, do të shqiptojnë gjoba", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës.

Pompat e benzinës në Mitrovicë për vazhdimin e punës pas orës 24:00 duhet të bëjnë kërkesë në komunë

MITROVICË, 10 DHJETOR (ER) - Të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve të Komunës së Mitrovicës e cila është drejtuar nga nënkryetari i komunës, Faruk Mujka. Në këtë mbledhje janë diskutuar dhe shqyrtuar çështje të rëndësishme nga fushëveprimi i bordit dhe drejtorive komunale. Fillimisht fjalën e mori drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, i cili ka kërkuar nga bordi të merret një vendim për pompat e benzinës të cilat punojnë nga ora 24:00, kështu që ekzekutivi u pajtua për subjektet afariste të cilat merren me shitjen e karburanteve dhe lubrifikanteve, në rast të zgjatjes së orarit të punës duhet ta bëjnë kërkesën sipas rregullores komunale nr. 03/2014, "për

caktimin e orarit të punës për subjektet afariste në Komunën e Mitrovicës".

Drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Shukri Gashi, ka diskutuar për draft-raportin e performancës për inkasimin e të hyrave vetjake, duke thënë se gjatë javës do të mblidhen të gjithë drejtorët dhe do ta përpilojnë planin e veprimit për implementimin e të gjeturave nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Ndërsa shefja e kabinetit, Mevlyde Shala, i ka njoftuar anëtarët e bordit lidhur me draftplanin e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2019, e cila kërkoj nga drejtorët e drejtorive përkatëse ta plotësojnë me pikat që mendojnë t'i procedojnë për shqyrtim në Kuvend në vitin 2019.



ADEM DEMAÇI DHE DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT E KOMBEVE TË BASHKUARA!



Behxhet Sh. SHALA,
drejtor ekzekutiv i
KMDLNj-së

Më 10 dhjetor 1948 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara nxori dhe shpalli Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut e cila me të drejtë konsiderohet si Kushtetutë Botërore për të Drejtat e Njeriut. Si çdo Kushtetutë, edhe kjo Kushtetutë Botërore e të Drejtave të Njeriut shkelet apo nuk respektohet edhe nga shtetet që e kanë pranuar dhe që e kanë bërë pjesë të legjislacionit vendor. Në kohën kur Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara shpalli Kushtetutën Botërore për të Drejtat e Njeriut në Kosovën e okupuar u lind Adem Demaçi i cili pikënisjen dhe pikësynimin e veprimtarisë jetësore e kishte të përmbledhur në tekstin e Deklaratës Universale përkatësisht në Nenin 1 të kësaj Deklarate (ende të pashkruar) se: "Të gjithë njerëzit linden të lirë dhe të barabartë në pikëpamje të dinjitetit të të drejtave. Ata janë të pajisur me arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëritjetrit me një frymë vëllazërore". Në Nenin 1 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut e Kombeve të Bashkuara është e përmbledhur e tërë veprimtaria njerëzore, kombëtare, politike, kulturore si dhe paraqet përmbajtjen e jetës së Adem Demaçit, Mendelës dhe Sakharovi shqiptar, shqiptarit të keqtrajtuar, të arrestuar, të dënuar, të syrgjynosur, të shpërngulur me dhunë nga shtëpia dhe trojet e veta, të zhdukur, të dhunuar, por asnjëherë të detyruar të heqë dorë nga e drejta e dhënë nga natyra dhe Zotit, e drejta të lindë i barabartë, të zhvillohet sikur të gjithë të tjerët, të jetojë me dinjitet duke i respektuar të gjitha këto të drejta dhe vlera, edhe për ata që i mohuan dhe i shkelën të gjitha këto të drejta, regjimi i Jugosllavisë dhe Serbisë.

Që nga viti 1958 (10-vjetori i Deklaratës Universale) kur u burgos për herë të parë dhe u dënua me pesë vjet burgim të rëndë, Adem Demaçi ishte zëri dhe ndërgjegjja e të gjithë popujve të robëruar ndonëse fliste shqip dhe ishte shqiptar apo qytetar i Botës së robëruar e që gjakonte lirinë, me çdo kusht, duke e sakrifikuar veten, por duke i kursyer të tjerët. Rrugëtimi i Adem Demaçit

kundër robërisë dhe drejt lirisë ishte Marshi i Marathomakut, në vitin 1964 u dënua me 15 vjet burg për t'u ridënuar edhe me 15 vjet të tjera në vitin 1975. Matematikisht bëjnë 35 vjet të shqiptuar burg të rëndë, kurse mbi 28 vjet të mbajtura në kushte ku dinjiteti njerëzor nuk kishte tjetër kuptim përveç atij gramatikor - lingistik.

Adem Demaçi nuk kishte urrejtje ndaj askujt, madje as ndaj atyre që e dënuan dhe e mbajtën në kamp, llogoret e ish-Jugosllavisë. Gjatë qëndrimit në kamp, llogoret e ish-Jugosllavisë ishte academia politiko-kombëtare, morale dhe kulturore për të gjithë të burgosurit politikë shqiptarë dhe të kombeve të tjera, por edhe për ata që ishin dënuar për vepra të tjera dhe përpqeshin ta rigjenin: "rrugën e Zotit, rrugën e drejtësisë dhe jetës së ndershme".

Në kohën kur e nisi veprimtarinë Adem Demaçi, të drejtat e njeriut nuk njiheshin në Kosovë sepse bëhej luftë për mbijetesë njerëzore dhe kombëtare.

Adem Demaçi ishte shkrimtar i jashtëzakonshëm, orator i kalibrit të Ciceronit dhe Demostenit, humanist i përmasave botërore dhe marrja me politikë nuk ishte përcaktim i vullnetit të tij, ishte imponim i situatës për faktin se, sipas vlerësimit të Adem Demaçit, politika ua mori të drejtat shqiptarëve, me politikë edhe do të ketë mundësi të rikthehen këto të drejta.

Jam shumë i sigurt se në momentin kur shqiptarët do t'i fitonin të gjitha të drejtat që u takojnë, Adem Demaçi do të përfundonte të merrej me politikë, pa asnjë dyshim.

Angazhimi, veprimtaria dhe sakrificat e Adem Demaçit për të drejtat e njeriut për shqiptarët është në përputhshmëri të plotë me të gjitha nenet e Deklaratës, sot 70-vjeçare, Universale për të Drejtat e Njeriut. Nuk njoh njeri ta ketë përballur burgun më lehtë se Adem Demaçi dhe se dënimin me burg nuk e konsideroi si dënim, por si detyrë apo obligim për të kaluar nga terr (robëria), në dritë (liri).

Në përpjekje për liri për të gjithë popujt e robëruar, edhe shqiptarët ishin në robëri, Adem Demaçi i sfidoi zotat e pushtimit, i shpalli luftë Zeusit, e ndali kodrën me gjoks, e dogji emrin e tij në burg dhe nga hiri u shndërrua në Feniks të lirisë, Mandelë të Afrikës, Sakharov të Rusisë, Jan Pallah të Çekosllovakisë, përsëri me emrin që e kishte lënë Nëna Nazife dhe baba Zeqir - Adem Demaçi.

Te shqiptarët trimëria është sinonim i budallallëkut, prandaj edhe thuhet: "Trim budallë".

Adem Demaçi ishte Trim, Trim i Mençur, Trim i Urtësisë, Trim i Durimit dhe Trim i Fitim - Ngadhënjimit. Kur shqiptarët nga

dhuna detyroheshin të deklaro-heshin turq, Adem Demaçi e pagëzoi djalin e vetëm me emrin Shqiptar.

Kur shqiptarët detyroheshin t'i mësonin shkronjat nga Azbuka e Vuk Karaxhiqit, Adem Demaçi e pagëzoi vajzën me emrin Abetare. Se politika nuk ishte përcaktim i vullnetit të tij, Adem Demaçi e dëshmoi kur doli nga burgu më 21 prill 1999. Adem Demaçi u angazhua në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave të Lirive të Njeriut në Prishtinë duke e shndërruar këtë organizatë në burimin më të besueshëm për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe çdo Rezolutë apo raport ndërkombëtar i qarqeve vendimmarrëse mbështetej në të dhënat e KMDLNj-së dhe të Adem Demaçit.

Me ardhjen e Adem Demaçit në krye të KMDLNj-së u bë degëzimi dhe rrjetëzimi në tërë territorin e Kosovës dhe viseve ku jetonin shqiptarët si dhe u institucionalizua bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si Amnesty International, Human Rights Watch, FIDH, Helsinki Commitee for Human Rights etj.

Kur rrezikoheshin të drejtat e njeriut të komuniteteve joshqiptare: serbë, romë, ashkali, egjiptas, boshnjak, turq dhe goran, Adem Demaçi doli në mbrojtje të këtyre të drejtave dhe doli kundër dhunuesve të këtyre të drejtave. Ua hapi derën dhe ua shtriu dorën serbëve të ngujuar dhe të izoluar, luajti valle me romët, u bë pjesë e gazimit, por edhe pikëllimit për turqit, ashkallitë, egjiptasit, boshnjakët dhe goranët.

Në frymën e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut e formoi, në kuadër të KMDLNj-së Komitetin për Mirëkuptim, Paqe dhe Tolerancë, duke u shndërruar në urë bashkimi dhe bashkëpunimi midis popujve e jo midis politikave. Po në frymën e kësaj Deklarate, Adem Demaçi

refuzoi ofertën kryeadministratorit të Kosovës, Bernard Kushner, për pajtim me Serbinë, pa plotësuar kërkesat e Kosovës që ishin plotësisht të arsyeshme dhe kusht i domosdoshëm për pajtim, qoftë edhe si nismë.

Adem Demaçi i nënshkroi kallëzimet penale kundër Sllobodan Millosheviqit dhe udhëheqësve të tjerë politikë, ushtarakë dhe policorë serbë, të dyshuar për krime lufte e që u gjykuan e disa u dënuan nga Tribunali Ndërkombëtar për Krime Lufte në Hagë.

Adem Demaçi ishte luftëtar i vërtetë i të drejtave të njeriut i cili armë për këtë luftë e kishte ndërgjegjen dhe vetëdijen e lartë, që e përjashtonte dhunën, urrejtjen dhe ksenofobinë. Për këtë arsye në vitin 1969 Amnesty International ia njehej statutin e të Burgosurit të Ndërgjegjes.

Në vitin 1991 Parlamenti Evropian ia ndanë "Çmimin Saharov" për Lirinë e Mendimit. Në vitin 1992 u nominua për Çmimin Nobel për Paqe. "Universidad de Complutense" i Madridit, në vitin 1992, i jep Çmimin kundër Racizmit dhe Ksenofobisë.

Universiteti i Oslos në Norvegji në vitin 1995 i jep Çmimin për të Drejtat e Njeriut. Për të dytën radhë, në vitin 2016, u nominua për Çmimin Nobel për Paqe.

Këto ishin çmimet për angazhimin dhe përparimin e të drejtave të njeriut, kurse për angazhim në planin kombëtar dhe politik u nderua në vitin 2010 me Urdhrin Hero i Kosovës. Në vitin 2012 nga Presidenti i Shqipërisë, me Urdhrin "Nderi i Kombit".

Angazhimi dhe sakrificat e Adem Demaçit u dha kuptim të drejtave të njeriut në Kosovë, u dha shpresë të gjithë popujve të robëruar se liria nuk mund të fitohet vetëm e vetëm nëse shkelni mbi rrugën drejt lirisë e shtruar me kupëza (Nene) të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, por se duhet të bëni shumë mund

dhe shumë punë, shumë sakrificat personale, familjare, njerëzore, kombëtare, të derdhni shumë djersë dhe, në raste të caktuara, edhe gjak, të demonstroi kulturë dhe moral më të lartë se shkelësi i të drejtave të njeriut apo pushtuesi, të mos e harroni të kaluarën, por të mos përpiqeni apo shpresoni ta ndërtoni të ardhmen mbi themelet e një të kaluarë të tillë. Këtë rrugë e ka preferuar, por edhe e ka zbatuar Prometheu i të drejtave të njeriut në Kosovë, rajon dhe në planin global. Jeta, sakrificat dhe vepra e Adem Demaçit është pjesë e çdo Neni të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut e Kombeve të Bashkuara, e të gjitha Kushtetutave të Botës që rregullojnë të Drejtat e Njeriut dhe është Engjëlli Mbrojtës si dhe frymëzim për të gjithë popujt e robëruar të cilëve u mohohet liria, dinjiteti, arsimit, zhvillimi dhe ardhmëria.

Për këtë arsye, nëse Parlamenti Evropian, për ta përjetësuar lirinë e shprehjes dhe lirinë e mendimit, si vlerat kryesore dhe elementare të drejtave të njeriut, e jep Çmimin Saharov, Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet ta ndajë Çmimin Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut - Adem Demaçi.

Deri më tani kryeqyteti i të drejtave të njeriut në Evropë ishte Kosova, kurse kryepersonazhi i këtyre të drejtave ishte dhe mbeti Adem Demaçi.

Adem Demaçi ishte një kohë të gjatë kryetar i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave të Lirive të Njeriut në Prishtinë kurse, deri më 26 korrik 2018, kur kaloi në përjetësi, ishte kryetar Nderi i KMDLNj-së. Ky është propozim i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut për ta shënuar 70-vjetorin e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara dhe Kushtetutën Njerëzore, Kombëtare dhe Morale të të Drejtave të Popujve të Robëruar - Bacë Adem Demaçin.



Macroni në diskutime për ta qetësuar situatën

PARIS, 10 DHJETOR - Presidenti francez Emmanuel Macron u takua të hënën me politikanë, përfaqësues të sindikatave dhe udhëheqës të biznesit, për t'i dëgjuar shqetësimet e tyre. Në mbrëmje, Macroni do t'i drejtohet vendit përmes një fjalimi në televizion, dalja e parë publike në më shumë se një javë, ndërkohë që protestat e "Jeleëve të verdhë" kanë tronditur vendin. Protestat filluan si një lëvizje kundër rritjes së taksave të karburantit, por kërkesat janë shtuar, mes tyre edhe ato për dorëheqjen e presidentit.

Punëtorët në të gjithë vendin pastuan të dielën në mbrëmje mbeturinat e shkaktuara nga protestat si gurë apo makina dhe biznese të djegura. Rreth 2 000 veta u arrestuan të shtunën në të gjithë Francën. Ministria e Brendshme thotë se rreth 136 000 njerëz u mblodhën për të protestuar kundër kostos së lartë të jetesës. Protestuesit shprehën gjithashtu mospajtimin me presidentin Macron. "Më në fund, pas Parisit, Franca është në flakë dhe kjo është një përgjegjësi e madhe për presidentin Emmanuel Macron. Ai duhet të

japë përgjigje, të cilat janë të vonuara, për fat të keq. Pas kësaj do të ketë protestues që do të ndihen të kënaqur, por tani për tani ka shumë njerëz të cilët duan që presidenti ta japë dorëheqjen. Është tepër vonë, loja është hapur dhe këta njerëz do të qëndrojnë në rrugë", thonë protestuesit. Për javën e katërt të demonstratave të dhunshme, Franca mbylli Kullën Eiffel dhe monumentet e tjera turistike si dhe mobilizoi dhjetëra mijëra forca sigurie. Shumë dyqane në Paris i mbyllën vitrinat me kompensata



përpara protestave të së shtunës për ta shmangur shkatërrimin ose plaçkitjen. Policia bllokoi shumë nga bulevardet e gjera të

qytetit. Protesta pati në një numër qytetesh, përveç Parisit, duke përfshirë Marsejën, Bordonë, Lionin dhe Tuluzën.

Theresa May shtyn votimin për Brexitin

Kryeministrja britanike Theresa May vendosi ta shtyjë votimin e marrëveshjes për marrëveshjen e largimit nga Bashkimi Evropian. Ajo u tha deputetëve se çështja e kufirit irlandez ishte çështja më e diskutueshme rreth marrëveshjes për të cilën ajo nuk i ka votat e mjaftueshme

LONDËR, 10 DHJETOR - Kryeministrja britanike Theresa May vendosi ta shtyjë votimin e marrëveshjes për marrëveshjen e largimit nga Bashkimi Evropian, që ishte arritur me Brukselin gjatë muajit nëntor. Kryeministrja May u tha deputetëve se çështja e kufirit irlandez ishte çështja më e diskutueshme rreth marrëveshjes për të cilën ajo nuk i ka votat e mjaftueshme.

Parlamenti pritej të votonte sot (e martë), nëse e pranon marrëveshjen që kryeministrja May e ka arritur me Bashkimin Evropian për largimin e Britanisë nga blloku.

Shtyrja e votimit ndodhi pak orë pasi që Gjykata Evropiane e Drejtësisë, tha të hënën se Mbretëria e Bashkuara mund ta anulojë njëanshëm Brexitin, duke shtuar shpresat e pro evropianëve para votimeve në Parlamentin britanik për marrëveshjen e kryeministres

Theresa May, për largimin nga Bashkimi Evropian. Vetëm 36 orë para votimit të së martës, Gjykata tha se Londra mund ta tërheqë njëanshëm dhe pa dënime artikullin e 50 për largimin nga BE-ja. "Mbretëria e Bashkuar është e lirë të anulojë në mënyrë të njëanshme njoftimin për qëllimin e saj për t'u tërhequr nga BE-ja", thuhet në vendimin e gjykatës. "Një anulim i tillë, i vendosur në përputhje me kërkesat e kushtetuese kombëtare, do ta kishte efektin që Mbretëria e Bashkuar të mbetet në BE nën kushte të pandryshuara", thuhet në vendim.

E ardhmja e BREXIT-it mbetet thellësisht e pasigurt pasi dhjetëra ligjvënës janë zotuar publikisht të votojnë kundër marrëveshjes së kryeministres May.

Në referendumin e 23 qershorit të vitit 2016, 17.4 milionë votues apo 52 për qind mbështetën Brexitin, ndërsa 16.1 milionë apo 48 për qind votuan për të mbetur pjesë e



bllokut. Ndërkohë kritikët e marrëveshjes së Britanisë për largimin nga BE-ja po bëjnë thirrje për rinegociimin e kushteve të vendosura. Marrëveshja e arritur që pritej të votohej në Dhomën e Ulët të Parlamentit britanik sot (e martë) është shtyrë nga kryeministrja May. Marrëveshja kundërshtohet nga kritikët mes radhëve të mbështetësve të Brexitit si dhe nga

ata që dëshirojnë qëndrimin e Britanisë në Bashkimin Evropian. Qeveria paralajmëroi se nëse ligjvënësit kundërshtojnë marrëveshjen e arritur, rrezikohet që Britania të mbetet në Bashkimin Evropian.

Politikanë dhe kundërshtuesit e Brexitit u mblodhën në Londër të dielën për ta denoncuar marrëveshjen e arritur, e cila do të

votohej sot (e martë) në parlament. "Brexit do t'i dëmtojë standardet tona mjedisore, të drejtat e punës, të drejtat e njeriut. Shtetasit e BE-së që krijuan këtu në mirëbesim jetën e tyre, tashmë ndihen jo të mirëpritur. Ne do ta refuzojmë Brexitin pasi nuk është lloji i politikës që ne dëshirojmë", deklaroi deputetja e Partisë së Gjellbër, Caroline Lucas.

Pompeo: ShBA-ja dhe Britania mbesin aleat pavarësisht Brexitit



UASHINGTON, 10 DHJETOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, premtoi raporte të ngushta me Britaninë nëse vendos për dalje të plotë nga Bashkimi Evropian. Pompeo tha se Shtetet e Bashkuara dhe Britania punojnë tepër ngushtë

së bashku në të gjitha frontet e marrëdhënieve tona, përfshirë tregtinë. "Nëse ka një Brexit të vështirë, mbetem shumë i bindur se Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëria e Bashkuar do të vazhdojnë të kenë një marrëdhënie të veçantë", tha Pompeo

në një intervistë radiofonike për Hugh Hewitt.

Komentet bëhen në kohën kur kryeministrja britanike Theresa May e ka të vështirë kalimin në parlament të marrëveshjes për Brexit, pasi atë nuk po e mbështesin shumica e deputetëve.

Juncke takon Conte para samitit evropian

BRUKSEL, 10 DHJETOR - Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, do ta presë të mërkurën në Bruksel kryeministrin italian Giuseppe Conte për një takim pune para samitit

evropian të enjten, njoftoi të hënën Komisioni Evropian. "Takimi do të zhvillohet gjatë pasdites", sqaroi zëdhënësja e Komisionit Evropian, Mina Andreeva, në një konference me

gazetarë në Bruksel. Të martën e kaluar Conte i premtoi BE-së një buxhet të ri italian për ta shmangur një procedurë të shkeljes. Komisioni Evropian hodhi poshtë më 23 tetor projektbux-

hetin italian për vitin 2019, që zyrtarisht parashikon një deficit prej 2.4 % të PBB-së përpara se t'i hapë rrugë një procedure që mund të çojë deri në vendosjen e sanksioneve.



NJË LIBËR DHE NJË AUTORE E JASHTËZAKONSHME

(Hanëmshahe Ilazi, "Gratë e huaja për shqiptarë dhe shqiptaret e diasporës", "Koha", 2018)



**Prof. dr. Sabile
KEÇMEZI-BASHA**

Që në fillim dua ta përgëzoj zonjën Hanëmshahe Ilazi për librin e mrekullueshëm që na solli sot në këtë ditë promovimi. Thonë se vetëm një mendje e ndritur mund të ketë një ide brilante për të shkruar një libër të tillë për gratë e fuqishme anekënd rruzullit, që patën guximin e kurajën ta ngrehin zërin për padrejtësitë e shumta që iu bënë popullit shqiptar.

Zonja Hanëmshahe, siç e njohim të gjithë, me një vizion të një gruaje të vendosur, grumbulloi, sistemoi dhe hodhi në letër të gjitha të dhënat për angazhimin e grave të shquara, se çfarë bënë dhe me çfarë peripecish u ballafaquan në arenën ndërkombëtare vetëm për të mbrojtur një popull të pambrojtur.

Duhet thënë edhe këtë, kur para disa muajve zonja Ilazi më kishte propozuar për t'u bërë recensente e këtij libri, drejtën thënë, isha tej mase e nxënë me disa shkrime të mia, por duke e pasur mike dhe, duke i njohur aftësitë e saj krijuese, e mora përsipër ta lexoja tekstin e librit. Libri ishte një risi në shkrimet tona. Unë kam shkruar shumë punime për gratë, bile në një konferencë shkencore kam prezantuar kumtesën

"Heroizmi i gruas shqiptare parë nga të huajt", por tema që shtjellon zonja Hanëmshahe, ka krejtësisht tjetër përmbajtje, ajo me një përkushtim prej një studiueseje, të tërë një libër ua kushton të gjitha atyre grave, që bënë shumë për Kosovën në veçanti dhe për shqiptaret në përgjithësi. Në një mënyrë, libri i prof. Hanëmshahe Ilazit mund të thuhet lirshëm është edhe një monument falënderues për të gjitha ato gra që bënë dhe ende po bëjnë për ne, duke e ngritur lart, në agjendat ndërkombëtare, çështjen e Kosovës.

Autorja Hanëmshahe Ilazi, me gjasë, gjatë gjithë punës që bëri në këtë libër, u bazua në parimin e Xhon Ueslejt kur thotë: "Bëj gjithë të mirën që mundesh, me të gjitha mjetet që mundesh... Për sa kohë të mundesh". Dhe,

duhet thënë se ajo i bëri të gjitha këto dhe ja rezultati, punën shumëvjeçare e kurorëzoi me sukses, libri doli i përkryer.

Librin "Gratë e huaja për shqiptarë dhe shqiptarët e diasporës" autorja e ka sistemuar në dy pjesë kryesore: 1. "Gratë e huaja për shqiptarë" dhe 2. "Shqiptaret e diasporës". Pjesa e parë ka njëmbëdhjetë kapituj si: 1. Udhëpërshkrueset, 2. Politikanet, 3. Për të drejtat e njeriut, 4. Humanistet, 5. Të martuara për shqiptarë, 6. Albanologët dhe ballkanologët, 7. Antropologët, etnologët, gjeologët, arkeologët dhe historikanet, 8. Përkthyeset, 9. Fotografet dhe reporterët e luftës-gazetaret, 10. Shkrimtarët, piktorët, aktorët, dirigjentet, flautistët, 11. Të tjera. Pjesa e dytë ndahet në nëntë kapituj: 1. Humanistet dhe mjeket, 2. Shkrimtarët, 3. Shkencëtarët, 4. Sopranot dhe solistet, 5. Politikanet dhe të drejtat e njeriut, 6. Artistët, piktorët, skulptorët, 7. Ushtarakët dhe sportistët, 8. Gazetaret, veteranët e arsimit, mësueset e profesorët e shkencave, 9. Afaristet. Libri veç, literaturës, përfundimit në shqip dhe anglisht, ka të botuar edhe mendimet e recensentëve. Në libër janë të përfshira gjithsej 168 gra të famshme që bënë çdo gjë vetëm që popullin shqiptar ta bëjnë të lirë dhe të pavarur. Duhet përmendur emrat si Medlin Ollbrajt, Hillari Klinton, Angela Merkelin, Nënë Terezë, Miss Mary Edith Durhamin, që autorja me një kujdes të veçantë flet për angazhimin e tyre që patën si para luftës, gjatë luftës dhe pas luftës në Kosovë.

Duke u ngjitur shkallëve të historisë dhe duke analizuar veprimtarinë e tyre vijnë deri te bijat tona që me punën dhe aktivitetin që zhvilluan jashtë atdheut, bënë shumë që emri i Kosovës të ndërkombëtarizohet dhe ta sensibilizojnë çështjen shqiptare. Safete Sofia Juka, Majlinda Kelmendi, Rita Ora e shumë e shumë gra të tjera të kombit shqiptar janë pjesë të këtij libri.

Duhet thënë sinqerisht se autorja Hanëmshahe Ilazi ka bërë një punë të mrekullueshme ngaqë njerëzit një ditë do të harronin se çfarë kemi thënë, madje do të harronin edhe çfarë kemi bërë por, nëse diçka mbetet e shkruar, kjo kurrë nuk do të harrohet. Andaj, zonja Hanëmshahe, të tërë angazhimin e grave të shquara, e që nuk është pak, nëpër

shumë vite veprimi, e voli pa lodhje, e shkroi dhe e përfshiu në libër, që ajo të mos harrohet dhe të mos zhduket kurrë, gjeneratë pas gjenerate.

Duke marrë parasysh faktin se një literaturë e këtillë apo e ngjashme ka munguar gjerë më tani, e mirëpritëm botimin e këtij libri, duke e vlerësuar këtë iniciativë, njëkohësisht duke pritur nga pena e saj e frytshme të kemi edhe shumë të libra të tjerë po të këtij niveli.


Libri pa dyshim përbën një rast dhe mundësi njohjeje të rrugës së vështirë nëpër të cilën ka

kaluar liria jonë. Lexuesit do ta shohin angazhimin, por edhe peripecitë e shumë grave si: Medlin Ollbrajt, Hillari Klinton, Angela Merkelin e shumë të tjera që u angazhuan për lirinë e Kosovës dhe në këtë mënyrë do të kuptojmë se me çfarë çmimi është fituar pavarësia. Duke njohur çmimin e lirisë, profesora Hanëmshahe Ilazi jep mesazhin se, "brezat e ardhshëm do ta duan dhe çmojnë më shumë lirinë, do ta ruajnë dhe mbrojnë më mirë atë, do ta përparojnë e forcojnë me shembullin e atyre që u

angazhuan për të".

Dhe krejt në fund, duke e lexuar librin "Gratë e huaja për shqiptarë dhe shqiptaret e diasporës", falënderojmë profesor Hanëmshahe Ilazin dhe uroi që nga kjo zonjë të kemi prurje të tjera të kësaj natyre, ngaqë periudha që trajton ajo nuk është shteruar ende. E lus si mike, që edhe më tej të shkruajë dhe të na lë dëshmi të një kohe që duhet mësuar dhe mbajtur në mend gjeneratat e reja.

(Fjalë e mbajtur në promovimin e librit më 18 tetor 2018 në Prishtinë)



E jashtëzakonshme

Zbret shkallët me makinë pasi ishte i dehur

Ka humbur kontrollin e veturës së tij dhe përfundoi në fund të shkallëve të "Trinita dei Monti", në zemër të Romës. Incidenti ndodhi të dielën. Skena u vu re nga disa agjentë të policisë vendore në shërbim te Sheshi "Spanja", të cilët më pas kanë iden-



tifikuar djalin i cili ishte larguar nga makina për të kërkuar ndihmë. 27-vjeçari rezultoi 'pozitiv' ndaj testit të alkoolit dhe u denoncua për 'drejtim të veturës në gjendje të dehur'.

FOTO E DITES



Një mace fle në një kuti në një dyqan mango në Bangkok të Tajlandës. /Reuters/

E rrallë

Verë me kanabis

Raportohet se pirja e alkoolit para kanabisit nuk është ide e mirë, por tani mund të blesh një verë të mbushur me kabanis, kështu që nuk e mundoni shumë veten për të vendosur se kë duhet ta pini të parën. Vera në ngjyrë të gjelbër të ndritshme ka dalë në shitje online për 20 paund. Winabis përmban vajra që rrjedhin nga kanabisi, ndërsa vera konsiderohet tërësisht ligjore. Winabis është hera e parë që ka futur kanabis në pije alkoolike.



BARSOLETA E DITËS



Babai, djalit:
 - Si po ecin mësimet?
 - Po mësoj aq sa di.
 - Mos i mëso ato që i di, por ato që s'i di!




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
 Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
 Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
 Regjia: Malcolm D. Lee




Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
 Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
 Regjia: Ruben Fleischer
 Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info**, **www.kinoabc.info**, **fb: Kino ABC**.



DASHI

Sot jeni aq komod sa nuk keni aspak dëshirë


të reagoni apo të vendosni. Do ta lini gjithçka në dorë të të tjerëve dhe po ju pëlqen kjo ndjesi.



DEMI

Keni pranë vetes një mik të vërtetë që ju

këshillon dhe ju rri pranë kur ju jeni në vështirësi. Sot është dita për t'i qenë mirënjohës.



BINJAKËT

Çdo gjë që ka të bëjë me shëndetin tuaj

ose të familjarëve sot ju ka mërziur disi. Kontrollat e shpeshta do të jenë ato që do t'ju qetësojnë.



GAFORRJA

Gjërat e vogla janë ato që do ta bëjnë

lumturinë tuaj sot. Partneri është bashkudhëtari juaj në ëndërrën për të ardhme së bashku.



LUANI

Ato që thuhet në momentin e gabuar

mund të prekin njerëz që për ju janë vërtet të rëndësishëm. Sot do të pendoheni për një fjalë të thënë.



VI RGJËR ESHA

Do t'ju duhet të jeni mjaft të progra-

muar sot. Punët dhe agjenda e ngarkuar që keni nuk do t'ju lënë asnjë çast të lirë për t'u çlodhur.



PESHORJA

Një ditë e zhurmshme kjo e sotmja e karakterizuar nga humori dhe të qeshura pa fund. Familja është streha juaj e ngrohtë në çdo çast.



AKREPI

Arti dhe muzika janë ato që do t'ju shoqërojnë përgjatë gjithë ditës. Sot do të ecni me zemër dhe jo me arsye.



SHIGJETARI

Sot po shpresoni të mos keni vizita të paprogramuara, por do të ndodhë krejt e kundërta. Do t'ju ngatërrohen situatat dhe personat.



BRICJAPI

Biznesi dhe marrëveshjet janë pika juaj e fortë sot. Do t'ju kërkojnë ndihmë dhe do të dini të jepni atë që do t'ju kërkohet pa shumë problem.



UJORI

Entuziazmi juaj që fillon që në orët e para të mëngjesit do t'i lërë pa fjalë bashkëpunëtorët tuaj. Vitaliteti që ju shoqëron sot do të bëjë të merrni vendime interesante.



PESHQIT

Edhe pse dita e sotme është më se e zakonshme, për ju do të shndërrohet në një ditë festë. Lajmi që do të merrni do t'ju gëzojë pa masë.

Chris Brown me album të ri



Chris Brown ka paralajmëruar albumin e ri që pritet të dalë në vitin 2019. Ky album do të emërtohet "Indigo" dhe do të dalë menjëherë pas festave të fundvitit. Më pas priten të publikohen këngët


"Privacy", "Questions", "Party" e shumë të tjera. Po në këtë album do të jetë edhe kënga e tij së bashku me reperin Drake dhe një këngë tjetër me këngëtares Ella Mai.

Pas ndarjes bashkëshorti e kërkon atë në mënyrë depresive



Reperja e njohur Cardi B javën që shkoi përmes një postimi në rrjetin e saj social në "Instagram" konfirmoi ndarjen nga bashkëshorti Offset. Kjo ndarje erdhi për shkak të tradhtisë së reperit Offset. Mirëpo, sipas Offsetit, këto janë vetëm shpifje

dhe nuk ka asgjë të vërtetë. Burime të "TMZ"-së thonë se ai po e kërkon Cardi B në mënyrë depresive. Dhe misioni i tij tash është ta rikthej besimin e saj sa më shpejt që të jetë e mundur. Offset dhe Cardi B kanë një vajzë së bashku, e cila ka vetëm disa muaj që nga lindja.



Jennifer Anniston: Martesa e sukseshme nuk do të thotë se do të zgjasë përjetësisht

Jennifer Anniston ka qenë dy herë e martuar, me Brad Pittin dhe Justin Therouxin. Por edhe pse martesat e saj përfunduan, aktorja nuk e sheh si diçka të keqe. Në një intervistë për "Elle" është shprehur se martesat e sukseshme

nuk zgjat përjetësisht. "Martesat e mia, të dyja kanë qenë shumë të sukseshme, për mendimin tim personal. Ne zgjodhëm të ishim të lumtur dhe ndonjëherë lumturia nuk ekzistonte më brenda asaj marrëveshje", ka bërë me dije ajo.

Pas ndarjes bashkëshorti e kërkon atë në mënyrë depresive



Reperja e njohur Cardi B javën që shkoi përmes një postimi në rrjetin e saj social në "Instagram" konfirmoi ndarjen nga bashkëshorti Offset. Kjo ndarje erdhi për shkak të tradhtisë së reperit Offset. Mirëpo, sipas Offsetit, këto janë vetëm shpifje

dhe nuk ka asgjë të vërtetë. Burime të "TMZ"-së thonë se ai po e kërkon Cardi B në mënyrë depresive. Dhe misioni i tij tash është ta rikthej besimin e saj sa më shpejt që të jetë e mundur. Offset dhe Cardi B kanë një vajzë së bashku, e cila ka vetëm disa muaj që nga lindja.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

SPORT

QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

LIVERPOOL - NAPOLI

1

INTER MILAN - PSV

GG3+

BARCELONA - TOTTENHAM

1

Magani: Kosova ende është pas Shqipërisë

Artur Magani ka thënë për "Epokën e re" se me dëshirë do të qëndrojë edhe për një kohë të gjatë në futbollin e Kosovës, i cili është ende pas futbollit të Shqipërisë. "Në Shqipëri janë më përpara në shumë elemente dhe terrenet janë shumë herë më të mira se në Kosovë", ka deklaruar Magani, i cili ka apeluar që të "kursehen" nga kritikantët trajnerët e ardhur nga Shqipëria



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Sulmuesi nga Shqipëria, Artur Magani, është ndër lojtarët më të mirë në futbollin e Kosovës, kurse tash është kampionati i dytë që Magani luan në Kosovë. I kontaktuar të hënën nga redaksia e sportit e gazetës "Epoka e re", Artur Magani ka folur për periudhën prej se ka 'aterruar' në futbollin e Kosovës, duke thënë se nuk ka ndonjë ndryshim të madh nga kampionati i kaluar me kampionatin aktual. "Gjendja është e njëjtë sikurse vitin e kaluar, po ashtu edhe niveli i një kampionati që do të jetë i luftuar deri në ndeshjen e fundit", ka thënë Magani, i cili vitin e kaluar ishte pjesë e skuadrës së Lirisë dhe tash është pjesë e Feronikelit.

Sulmuesi i talentuar ka bërë me dije se pas

përfundimit të kampionatit të kaluar kishte shumë oferta, por e bindi ajo e skuadrës nga Drenasi. Ndërsa është i lumtur edhe përkundër faktit se nuk është gjithmonë në formacionin nismëtar. "Mbas atij viti të mirë me Lirinë kisha shumë oferta, por Feronikelin e pashë si ekipin më të mirë për të vazhduar. Sigurisht se jam i kënaqur, edhe pse në të gjitha ndeshjet nuk kam luajtur titullar. Konkurrenca që kisha te Liria dhe tash te Feronikeli ka dallim të madh", ka shtuar ai. Magani është i kënaqur me rezultatet e arritura me Feronikelin në sezonin vjesh-tor dhe i pëlqen gara për titull të kampiones. Më pas sulmuesi shqiptar ka bërë edhe një krahasim në mes futbollit në Shqipëri dhe Kosovë. Sipas tij, shumë gjera janë përpara në Shqipëri. "Nëse do të bëja një krahasim midis kushteve që kisha në Shqipëri dhe Kosovë, mund të them se në

Kosovë paguhem më shumë dhe nëse vazhdon kështu, do të qëndroj gjatë këtu. Një dallim tjetër është se këtu kampionati duhet të përfundojë në muajin dhjetor për shkak se nuk ka kushte për të luajtur, për çka nuk jam aspak dakord. Në Shqipëri janë më përpara në shumë elemente dhe terrenet janë shumë herë më të mira se në Kosovë", ka deklaruar Magani.

Sulmuesi ka lavdëruar edhe sjelljet e lojtarëve të Kosovës, por ka kritikuar analistët për mënyrën se si i vlerësojnë trajnerët nga Shqipëria që janë duke punuar në klubet e Kosovës. "Për të mirë do ta veçoja sjelljen e futbollistëve të Kosovës karshi neve që jemi nga Shqipëria edhe pse jemi të gjithë shqiptarë. Ndërsa për të keq, ndoshta gabohem, por analistët e Kosovës i sulmojnë pa të drejtë trajnerët shqiptarë që kanë ardhur në Kosovë", ka përfunduar Magani.

SHKURT

Levante pret ta hua- zojë Sadikun te Lugano

Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Armando Sadiku, në afatin kalimtar të janarit mund të ndryshojë skuadër. "Corriere del Ticino" raporton se sulmuesi kuqezi mund të rikthehet te skuadra e Luganos në Zvicër në mënyrë që ta rikthejë formën e dikurshme. 27-vjeçari që është pjesë e skuadrës së Levantes është në fazën e fundit të rikuperimit.

Zoffi: Nuk ka dallim në mes të Berishës dhe Strakoshës

Legjenda e portës italiane, Dino Zoff, e ka bërë një krahasim në mes dy portierëve të Kombëtares së Shqipërisë, Etrit Berishës (Atalantës) dhe Thomas Strakoshës (Lazios). "Mund të them se ata të dy janë portierë me shumë cilësi. Të jem i sigurt, nuk shoh shumë dallim mes tyre", ka thënë Zoff.

Williamsi: Humbjet e mia bëjnë lajm

Tenistja amerikane Serena Williams është e mësuar me presionin, me stadiumet plot sa herë që ajo luan dhe arrin thujtë gjithnjë t'i kënaqë fansat. "Kjo më bën të ndihem e vlerësuar", ka thënë motra e vogël Williams, fituese e 23 grand slameve në karrierë, që luan si profesioniste prej 23 vjetësh, që prej vitit 1995. "Megjithatë, fakt është se lajmet më të rëndësishme për mua janë kur unë humbas një ndeshje sesa kur fitoj një turne apo grand slam. Kjo ndoshta tregon se njerëzit besojnë shumë tek aftësitë e mia, te loja ime dhe se në këtë sport jam një teniste e fortë", ka thënë tenistja amerikane.

Haradinaj, bizneseve: Investoni në sport

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në përvjetorin e katërt të pranimit të Komitetit Olimpik të Kosovës në

Komitetin Olimpik Ndërkombëtar, u ka bërë thirrje bizneseve ta kthejnë vëmendjen tek investimet në sport. "Nëse jeni kampion në biznes, nëse keni arritur lart,

ju lutem ndani diçka edhe për kampionët në sport. Nëse jeni duke luftuar për t'u bërë kampionë, ka edhe sportistë që po luftojnë për t'u bërë kampionë, prandaj

financoni sportistët. Jemi shumë krenarë që e kemi medaljen e parë olimpikë, pasi gjysma e shteteve të botës nuk kanë ende medalje", ka thënë Haradinaj.



22-vjeçari i Bayernit: Do të pensionohem nëse vazhdojnë lëndimet

MUNCHEN, 10 DHJETOR - Sulmuesi i Bayern Munchen dhe Francës, Kingsley Coman, mund t'i japë fund karrierës së tij si futbollist profesionist, përkundër që është vetëm 22-vjeçar, nëse

vazhdojnë lëndimet e kycit të këmbës. Këtë sezon ai i ka bërë vetëm tri paraqitje për Bayernin, ndërsa i kishte bërë vetëm 21 dhe 19 në dy sezonet paraprake. Pas tre muajve i lënduar,

Coman luajti në dy ndeshjet e fundit të kampionit gjerman. "Ishte një vit i vështirë. Kur e lëndova veten, ishte fundi i botës për mua. Shpresoj se nuk do të duhet ta përjetoj atë që kam

kaluar, mjafton me kaq. Nuk do ta pranoj një operacion të tretë - kjo do të thotë se këmba ime nuk është për këtë nivel. Do të bëj një jetë tjetër, një jetë anonime", ka thënë Comani.



Tottenhami kërkon të 'pamundurën' ndaj Barçës



BARCELONË, 10 DHJETOR - Skuadra angleze Tottenham Hotspur kërkon në "Camp Nou" ndaj Barcelonës fitoren për ta siguruar kualifikimin në fazën e 1/8 së finales në Ligën e Kampionëve, që duket një mision vështirë i arritshëm për skuadrën e drejtuar nga Mauricio Pochettino, pasi skuadra e Barcelonës nuk ka pësuar humbje si vendës që nga viti 2013 kur u mposhtë nga Bayern Munchen. "Spurs" ka 7 pikë sa ka edhe Interi që luan ndaj PSV-së. Skuadra italiane synon fitoren ndaj PSV-së që ka humbur gjasat për kualifikim dhe në anën tjetër ta pres gabimin e Tottenhamit në Spanjë për ta arritur kualifikimin së bashku me Barcelonën nga Grupi B. Në Grupin A kualifi-

fikimin e kanë siguruar Atletico Madridi dhe Borussia Dortmund, po ka mbetur të përcaktohet se cila skuadër përfundon e para. Club Brugge do të luajë në Ligën e Evropës. Grupi C është ndër më interesantet në ndeshjet e fundit të fazës së grupeve. Napoli dhe Liverpooli do të përballen ndërmjet vete, ku italianëve një barazim u mjafton për ta arritur kualifikimin. Në anën tjetër anglezët duhet të fitojnë me dy gola epërsi për ta siguruar kualifikimin, derisa Paris Saint-Germain me një pikë do të jetë në 1/8 e finales. Nga Grupi C kualifikimin e kanë siguruar Porto dhe Schalke, kurse Galatasaray dhe Lokomotiv Moska kërkojnë synojnë kualifikimin në Ligën e Evropës.

GRUPI A		
21:00 Club Brugge - Atletico Madrid		
21:00 Monaco - Borussia Dortmund		
TABELA		
1. Atletico Madrid	5	12
2. Borussia Dortmund	5	10
3. Club Brugge	5	5
4. Monaco	5	1
GRUPI B		
21:00 Barcelona - Tottenham Hotspur		
21:00 Inter - PSV Eindhoven		
TABELA		
1. Barcelona	5	13
2. Tottenham Hotspur	5	7
3. Inter	5	7
4. PSV Eindhoven	5	1
GRUPI C		
21:00 Crvena Zvezda - Paris Saint-Germain		
21:00 Liverpool - Napoli		
TABELA		
1. Napoli	5	9
2. Paris Saint-Germain	5	8
3. Liverpool	5	6
4. Crvena Zvezda	5	4
GRUPI D		
18:55 Galatasaray - Porto		
18:55 Schalke - Lokomotiv Moscow		
TABELA		
1. Porto	5	13
2. Schalke	5	8
3. Galatasaray	5	4
4. Lokomotiv M.	5	3

Milwaukee mposhti Toronton, fitojnë San Antonio dhe Charlotte

TORONTO, 10 DHJETOR - Milwaukee fitoi 104-99 në fushën e Torontos, në përballjen mes dy ekipeve më të mira në Konferencën e Lindjes. Sfidë me rivalitet dhe emocione deri në fund, ku herë udhëhiqte njëra skuadër e herë tjetra. Për kanadezët u dalluan Ibaka me 22 pikë e Leonardo me 20, por në kahun tjetër shkëlqeu Antetokounmpo, autor i 19 pikëve dhe 19 rebaundeve për Bucksin, mbështetur edhe nga Lopez me 19 pikë e Brogdoni me 18. Gjithsesi, ekipi i Torontos ruan kreun në Lindje, por tashmë diferenca mes tij dhe Milwaukee është ngushtuar ndjeshëm. Rikthehet te fitorja skuadra e San Antonios, që mundi 110-97 Utah Jazzin, një përballje e komanduar nga basketbollistët e Spursit,



ndjeshëm më superior në parket, duke i dhënë një "leksion" të mirë rivalëve të Jazzit. DeRozan e mbylli me 26 pikë, Gay me 23 pikë e 15 rebaunde, ndërsa Aldridge shënoi 20 pikë, një trio që bëri diferencën në fushë.

REZULTATET		
Detroit - New Orleans	108-116	
Toronto - Milwaukee	99-104	
San Antonio - Utah Jazz	110-97	
New York - Charlotte	107-119	

SHKURT

Ronaldo: E meritoja 'Topin e Artë'

Ylli i Juventusit, Cristiano Ronaldo, është i bindur se ai e ka merituar "Topin e Artë". "Mendova se e meritoja, bëra gjithçka në fushë, numrat nuk gënjejnë. Por, nuk është fundi i botës, unë respektoj vendimin. Urime për Modriqin!", ka thënë Ronaldo. I pyetur se a është i zhgënjyer që nuk u shpall fitues, portugezi është përgjigjur: "Po, por jeta vazhdon dhe unë do të punoj shumë për ta fituar atë titullin e ardhshëm".

Interi në janar e dëshiron Ozilin

"The Sun" raporton se Arsenali ka vendosur të nxjerrë në shitje mesfushorin gjerman Mesut Ozil. Mesfushori u transferua tek Arsenali nga Reali i Madridit në verën e vitit 2013 dhe mund të largohet nga "Topçinjtë" për vlerën e 28 milionë eurove. Mesfushori gjerman, që nuk ishte grumbulluar në dy ndeshjet e fundit të skuadrës londineze, rrezikon të qëndrojë dy muaj jashtë fushave për shkak të problemeve në shpinë që iu shfaqën për shkak të qëndrimit të gabuar të tij teksa luante me orë të tëra në "Playstation". Skuadra e interesuar për transferimin e Ozilit është Interi.

Shkarkohet Calleja

Skuadra e Villarealit e ka shkarkuar trajnerin Javier Calleja. Shkarkimi i trajnerit Calleja ka ardhur pas rezultateve të dobëta që ka regjistruar skuadra spanjolle në këtë edicion ku gjendet në vendin e 17 me 14 pikë, një vend larg zonës që e dërgon në ligën e dytë të Spanjës.

Kloppin nuk e brengos asnjëherë forma e Salahut

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka thënë se nuk ka qenë asnjëherë i brengosur për formën e Mohamed Salahit, i cili shënoi tri gola në ndeshjen ndaj Bournemouthit të shtunën. "Nuk kam qenë asnjëherë i brengosur për formën e tij", ka thënë Klopp. Në 16 paraqitje të yllit egjiptian në këtë stinor të Premierligës i ka shënuar 10 gola dhe ka bërë pesë asistime.

Pogba ndihet i nënvlerësuar në United

Duket se gjërat sa po kalojnë e po vështirësohen për francezin Paul Pogba te Manchester Unitedi. Futbollisti raportohet se është ndier i nënvlerësuar me lënien jashtë në fitoren ndaj Fulhamit. Mesfushori e kaloi gjithë ndeshjen duke qëndruar në bankën rezervë pasi menaxheri Jose Mourinho refuzoi ta inkuadronte, pavarësisht se Djajtë e Kuq po merrnin fitoren e tyre më të thellë të sezonit në Ligën Premier. Një burim i klubit i ka thënë "Daily Star" se Pogba është i befashuar me veprimin e trajnerit portugez. "Paul është i hutuar sepse nuk është i vetmi që ka luftuar për të prodhuar më të mirën e tij në javët e fundit. Ai ndihet sikur është veçuar nga ekipi, por që është bërë një shembull për të tjerët. Është pak poshtëruese duke marrë parasysh statusin e tij në lojë", ka thënë burimi në fjalë.

Zbulohen detaje të reja rreth vdekjes së Astorit

Vazhdojnë hetimet në Itali për vdekjen tragjike të ish-kapitenit të Fiorentinës. Gazeta italiane "La Nazionale" ka zbardhur fakte të reja në lidhje me humbjen e jetës së 31-vjeçarit. Sipas medias italiane, Astori ka kryer vizita mjekësore një vit para se të ndodhte ngjarja dhe është vënë re nga kontrollet, se zemra e tij nuk funksiononte mirë. Barkushja e djathtë e mbrojtësit kishte një problem që haset shpesh te sportistët dhe, në të shumtën e rasteve, sportistët kanë humbur jetën. Sëmundja që ishte prekur Astori e quajtur "Displasia aritmogjenike" vret në mënyrë progresive qelizat e miokardit, duke i kthyer në yndyra që çojnë në probleme të funksionimit të zemrës dhe mund kthehen në vdekjeprurëse. Autoritetet italiane kanë nisur hetimin në qendrën mjekësore ku Astori kreu vizitat mjekësore një vit më parë dhe i gjithë faji bie mbi këtë qendër që nuk arriti të zbulonte dhe parandalonte sëmundjen e shfaqur.



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Belediyesi

Datë: 11.12.2018

Në bazë të nenit 18 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 4 paragrafi 4 dhe neni 29, Komuna e Prizrenit, rishpall:



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Drejtoria për Inspektorat

Titulli i pozitës së punës: Udhëheqës i Sektorit të Ndërtimit - UNM/020

Lloji i pozitës: I karrierës

Numri i Ekzekutuesve: 1 (një)

Kategoria funksionale: Niveli drejtues 1

Grada e vendit të punës: 7

Koeficienti: 8

Qëllimi i vendit të punës :

Zhvillimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të rregulloreve, standardeve dhe programeve në fushën e ndërtimit

Detyrat kryesore:

- Udhëheqë punën e gjithmbarshme të sektorit dhe ndihmon mbikëqyrësin në caktimin e objektivave dhe hartimin e planit të punës për përbushjen e këtyre objektivave ;
- Menaxhon me stafin e sektorit dhe bën ndarjen e detyrave tek varësit e tij , ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të siguruar shërbime cilësore;
- Ndihmon mbikëqyrësin në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësime me qëllim të ngritjes së efikasitetit në punë;
- Koordinon punët rreth inspektimit të ndërtimeve, instalimeve, renovimeve, zgjerimeve, ndryshimeve, shndërrimeve si dhe inspektimi i rrënimin të çfarëdo ndërtese apo strukture, përjashtuar punët e zakonshme për mirëmbajtjen e ndërtesave për të cilat nuk nevojitet leje ndërtimi;
- Monitoron punët rreth inspektimit të dokumentacionit teknik – projektet e ndërtimit, lejet e ndërtimit, inspektimi i lejeve të përdorimit të objekteve dhe koordinon aktivitetet e stafit të sektorit që ti përcjellin të gjitha ndërtimet qoftë ato me material të fortë ndërtimor, apo të objekteve montazh;
- Bashkëpunon me DUPH-në, rreth lejeve urbanistike, të ndërtimit etj;
- Koordinon aktivitetet për rrënimin e të gjitha objekteve ndërtimore të cilat janë të ndërtuara pa lejen e organeve kompetente komunale;
- Bën vlerësim të rregull të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara;

Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri dhe përvojë nga fusha e ndërtimitarisë;
- Shkathësi të lartë në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga varësit;
- Shkathësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negociim;
- Fleksibilitet ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës, përfshirë zgjidhjen e problemeve;
- Shkathësi kompjuterike të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, internet)

Kushtet:

- Diplomë universitare (Fakulteti i Ndërtimitarisë ose i Arkitekturës)
- Së paku 4 vite përvojë pune profesionale

Dokumentacioni i kërkuar për aplikim:

- Fotokopja e vërtetuar e diplomës;
- Vërtetim mbi përvojën e punës;
- Dy - rekomandime;
- Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
- Certifikata e lindjes;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikata të ndryshme.

Konkursi ngel i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit, duke filluar nga data e publikimit më 11.12.2018 deri më datën 26.12.2018 që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Instrukione Aplikimi: Kërkesa (Aplikacioni) për punësim gjendet në <http://kk.rks-gov.net/prizren/Shpalljet/Konkurset.aspx>, dhe pas plotësimit sipas çdo pike të aplikacionit, i bashkëngjitni dokumentet të cilat kërkojnë sipas konkursit dhe mund të aplikoni tek ne drejtpërdrejtë -Adresa jonë: në sportelin e pranimit nr. 2, në objektin e administratës komunale në Komunën e Prizrenit, rr. "Remzi Ademaj" p.n. -Prizren. **VËMENDJE:** Njoftimet i gjeni në Ueb, ndërsa në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038 / 200 44715 prej orës 08:00 – 16:00.

Aplikacionet e pranuar pas afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen me shkrim (e-mail) në rast të mos konfirmimit të kandidatit në e-mail do të njoftohet me telefon dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para komisionit, në rast të mosnjohjes të dokumentacionit origjinal intervistues, kandidatët nuk do të mund të vazhdojnë në hapat e mëtejshëm të procedurave të rekrutimit. Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Zyra e Personelit



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Tarih: 11.12.2018



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

03/L-149 sayılı Kosova Cumhuriyeti Sivil Hizmet Yasasının 18.maddesi 3.fıkrası ve Sivil Hizmet İstihdam Sürecin 02/2010 sayılı Yönetmeliğin 4. maddesi 4. fıkrası ve 29 maddesi gereğince Prizren Belediyesi iş bu konuru yeniden ilan etmektedir :

İŞ YERİN DOLDURULMASI İÇİN KONKUR

Müfettişlik Müdürlüğü

İşyeri makamı: İnşaat Sektör Yöneticisi – UNM/ 020

Konum : Kariyer

